

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 5984
E premte, 24 janar 2020
çmimi 0.40 €

ShBA-ja i dhuron Shërbimit Korrektues pajisje në vlerë prej 100 mijë eurosh



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

AMBASADORI AMERIKAN NË BERLIN, RICHARD GRENELL, I DËRGUAR I POSAÇËM I PRESIDENTIT TË SHBA-SË PËR BISEDIME NDËRMJET KOSOVËS DHE SERBISË, KA QËNDRUAR PËR VIZITË NË KOSOVË

GRENELLI: KOSOVA TA HEQË TAKSËN, SERBIA TA NDALË FUSHATËN KUNDËR NJOHJEVE



Emisari i presidentit Donald Trump për bisedimet ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, Richard Grenell, ka kërkuar të enjten në Prishtinë që Kosova ta heqë taksën 100 për qind ndaj mallrave serbe, kurse nga Serbia ka kërkuar që ta ndalë fushatën kundër njohjeve të Kosovës. Pas takimit me liderët politikë të Kosovës, diplomati amerikan ka thënë se kjo është shumë e rëndësishme të ndodhë nëse palët duam përparime në zhvillimin ekonomik. Ambasadori Grenell ka mohuar se vizita e tij ka pasur për qëllim përfshirjen e ShBA-së në procesin e formimit të qeverisë së re

OPINION

SA ËSHTË REALIZUAR PLANI STRATEGJIK I ARSIMIT NË KOSOVË? F. 10

Ismajl
KURTESHI



TORNADOT DHE CIKLONET NË BRENDE SINË E PROTONEVE ELEKTRONEVE DHE NEUTRONEVE F. 11

Shkruan: Naim
KRASNIQI, fizikan



AKTUALE



PDK-ja: KOMUNA E PRISHTINËS TA TËRHEQË LEJEN PËR KUSHTET E NDËRTIMIT NË BADOVC F. 7

ZYRTARI I LARTË AMERIKAN NJOFTOHET ME TË ARRITURAT NË SEKTORIN E SIGURISË NË KOSOVË F. 7

EKONOMI

SHTRENJTOHET ÇIMENTO NË KOSOVË PËR 24.4 PËR QIND, REAGONJË BIZNESET F. 9

MTI-ja DHE ADA, MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI PËR T'I NDIHMUAR NDËRMARRJET E VOGLA DHE TË MESME F. 9

Vazhdon regresi në luftën kundër korrupsionit

Organizata ndërkombëtare Transparency International ka publikuar të enjten Indeksin e Perceptimit të Korrupsionit për vitin 2019. Indeksi radhit 180 vende dhe territore të botës në bazë të nivelit të perceptuar të korrupsionit në sek-

torin publik. Republika e Kosovës në indeksin e sivjetmë radhitet e 101-ta me 36 pikë. Ky rezultat do të thotë se ka shënuar përkeqësim në luftën kundër korrupsionit krahasuar me vitin paraprak, kur ka qenë në vendin e 93-të, me 37 pikë



RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepçisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERNATIONAL BANK VIENNA INSURANCE GROUP
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Lars-Gunnar Wigemark, shef i ri i EULEX-it

PRISHTINË, 23 JANAR (ER) - Ambasadori Lars-Gunnar Wigemark ka marrë detyrën e shefit të ri të Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX). Ai e ka pasuar ambasadorin Alexandra Papadopoulou, një diplomate greke, e cila e ka përfunduar detyrën e saj si shefe të EULEX-it

në korrik të vitit të kaluar. "Me padurim po e pres këtë emërim të ri dhe sfidues. Unë do të angazhohem ashtu që EULEX-i të vazhdojë të jetë partner i besueshëm për partnerët dhe miqtë e tij kosovarë, duke u ofruar kolegëve tanë të kamotshëm të sundimit të ligjit ndihmë konkrete, me kohë dhe të dobishme ashtu që ata të vazhdo-

jnë të bëhen më të fuqishëm dhe më të zotë për ta vazhduar rrugëtimin e tyre në drejtimin evropian", ka thënë Wigemarku. Lars-Gunnar Wigemark është një diplomat suedez. Ai ka shërbyer si shef i delegacionit të BE-së në Bosnjë e Hercegovinë dhe përfaqësues special i BE-së në këtë shtet. Wigemarku ka qenë edhe ambasador i BE-së në Pakistan.



Rama: Konferenca e donatorëve do të jetë një sukses

Kryeministri Edi Rama tha se ne do të bëjmë çmos edhe me ndihmën e miqve të mëdhenj të Shqipërisë, që Konferenca e donatorëve të jetë një sukses, ndërkohë që e kemi shumë të qartë që për të përmbushur të gjithë nevojën e jashtëzakonshme nuk do të mjaftojë



TIRANË, 23 JANAR - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama deklaroi të enjten nga Italia se shifra përfundimtare për programin e rindërtimit nuk ka dalë ende, por të dhënat e konsiderueshme që janë mbledhur deri tani na japin një shumë që rrotullohet rreth 1 miliard euro. "Ne do të bëjmë çmos edhe me ndihmën e miqve të mëdhenj të Shqipërisë, ku Italia është pa asnjë dyshim ndër më të afërtit, që Konferenca e donatorëve të jetë një sukses, ndërkohë që e kemi shumë të qartë që për të përmbushur të gjithë nevojën e jashtëzakonshme nuk do të mjaftojë", tha Rama, ka njoftuar atsh.

Në një videomesazh nga Roma, pas takimeve të rëndësishme me kryeministrin Giuseppe Conte dhe ministrin e Jashtëm, Luigi Di Maio, në funksion të rindërtimit, në prag të Konferencës së donatorëve për

Shqipërinë, e cila do të mbahet në 17 shkurt në Bruksel nën kujdesin e presidentes së Komisionit Evropian, Ursula Von Der Leyen, kryeministri Rama tha se "jemi të mirëpërgatitur për të vijuar me veprime të tjera kurajoze në aspektin financiar, duke përfituar nga qëndrueshmëria e lartë makroekonomike që kemi garantuar në këto vite reformash, si edhe duke kombinuar disa skema financimi për rindërtimin, gjithnjë pa ndërprerë, se kjo është ambicia, apo reduktuar programet e tjera të zhvillimit të mbrojtjes sociale". "Jam shumë mirënjohës dhe i inkurajuar nga vëmendja e veçantë dhe gatishmëria e plotë e kryeministrit Conte dhe ministrit të Jashtëm Di Maio, ndërkohë që do të vijojmë me takimin me kancelaren Merkel në fillimjavën e ardhshme dhe më tutje edhe me disa kontakte

kyçe të nivelit të lartë, në mënyrë që konferenca të jetë një sukses", tha Rama. Kreu i qeverisë tha se "planet e rindërtimit po ecin shpejt dhe brenda kalendarit të parashikuar për të mundësuar fillimin e ngritjes së banesave të para individuale në pranverë dhe përfunduar me shtëpitë në zonën rurale brenda vitit 2020. Po punohet edhe me planet e zonave të rindërtimit në qytetet

e prekura brenda perimetrit, ku ndërhyrjet do të jenë masive dhe procesi i projektimit natyrshëm pak më i gjatë. Por jemi brenda afateve të përcaktuara dhe ndërkohë është e qartë për të gjithë dhe dua ta ritheksoj se do të vijojmë t'u paguajmë qiranë e shtëpisë ku janë sistemuar njerëzit e prekur, deri kur t'i kthejmë në apartamentet e reja". Rama shtoi se jemi brenda afateve edhe me kalendarin

ambicioz të rindërtimit të gjithë shkollave në zonën e prekur, si edhe të spitalit të Laçit si dhe 5 qendrave shëndetësore që duhen ndërtuar nga e para. "E di shumë mirë që për njerëzit e prekur çdo ditë është e gjatë dhe pritja është e lodhshme, por ju lutem të gjithëve të mirëkuptojnë nevojën për durim dhe të kenë besim të plotë se askush nuk do të mbetet vetëm", theksoi Rama.

Meta: Shqipëria rrezikon kapjen totale të shtetit!

TIRANË, 23 JANAR - Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta i është drejtuar Komisionit të Venecias për dhënien e një opinionimi mbi procesin e zgjedhjes së anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë. Në dokumentin e publikuar nga Presidencia jepen argumentet ligjore të shkeljeve që ka bërë mazhoranca gjatë procesit të zgjedhjes së anëtarëve të kësaj gjykate. Kreu i shtetit shprehet se aktualisht "Shqipëria është në çekuilibër të plotë të mekaniz-

mave të kontrollit dhe balancës, rrezikon kapjen totale të shtetit". Presidenti shprehet se në shkelje totale ligjore, Kuvendi tentoi rrëmbimin e kompetencave kushtetuese të presidentit me qëllim kapjen e Gjykatës Kushtetuese. "Kur Qeveria, Kuvendi, të gjitha bashkitë, këshillat bashkiakë dhe thujtë të gjitha institucionet e pavarura, janë në duart e një partie të vetme: a i shërben kapja e Gjykatës Kushtetuese interesit politik për t'u shmangur kontrol-

lit dhe llogaridhënies?", thuhet në një prej pyetjeve që presidenti i ka dërguar Komisionit të Venecias. Gjithashtu, kreu i shtetit shpreh shqetësimin se Kuvendi i Shqipërisë nuk ka marrë parasysh asnjë prej këshillave që Venecia ka dhënë më herët për institucionet e Shqipërisë. "Asnjë reflektim nga Kuvendi ndaj këshillave të Komisionit të Venecias! Të dhënat e shtrembëruara dhe pyetjet vetësugjeruese të Kuvendit synojnë lexim të gënjeshtërt të situatës", thuhet



ndër të tjera në letër. Dokumenti voluminoz i Presidencës për Venecian i ka dërguar këtij komisioni informa-

cion të plotë të dokumentuar, dhe një listë pyetjesh që qartësojnë kushtetutshmërinë e veprimeve të secilit.

Vazhdon regresi në luftën kundër korrupsionit

Organizata ndërkombëtare Transparency International ka publikuar të enjten Indeks të Perceptimit të Korrupsionit për vitin 2019. Indeksi radhit 180 vende dhe territore të botës në bazë të nivelit të perceptuar të korrupsionit në sektorin publik. Republika e Kosovës në indeksin e sivjetmë radhitet e 101-ta me 36 pikë. Ky rezultat do të thotë se ka shënuar përkeqësim në luftën kundër korrupsionit krahasuar me vitin paraprak, kur ka qenë në vendin e 93-të, me 37 pikë



EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 23 JANAR - Rezultatet e Indeksit të Perceptimit të Korrupsionit (Corruption Perception Index- CPI) për vitin 2019 e zhvendosin Kosovën edhe më poshtë në radhitjen botërore të publikuar të enjten nga Transparency International, në kuadër të këtij indeksi. Kjo u bë me dije gjatë konferencës për media të mbajtur nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), degë e "Transparency International" - rrjetit global në luftën kundër korrupsionit. Me këtë rast Arben Kelmendi nga KDI-ja ka theksuar se, sikurse edhe në vitet e kaluara, edhe sivjet Transparency International (TI) ka publikuar rezultatet e Indeksit të Perceptimit të Korrupsionit, i cili përdor një metodologji të sofistikuar dhe informatat nga raportet e organizatave kredibile ndërkombëtare si Freedom House, World Bank, Bertelsmann Foundation, Global Insight dhe Varieties of Democracy Project. Ai ka thënë se Indeksi shfrytëzon sistemin e

vlerësimit prej 100 shkallësh në të cilin vlerësimi maksimal do të thotë 'vend i pastër nga korrupsioni', kurse vlerësimi prej zero pikë do të thotë 'vend shumë i korruptuar'.

Kelmendi ka njoftuar se në nivel global, prej 180 vendeve që marrin pjesë në këtë vlerësim, Danimarka vazhdon të radhitet e para, edhe këtë vit me një pikë më pak se vitin e kaluar (87 pikë) sa ka edhe Zelanda e Re. Sipas tij, vendin e tretë e mban Finlanda me 86 pikë pasuar nga Singapori, Suedia dhe Zvicra me 85 pikë.

Kurse Florent Spahija nga KDI-ja ka deklaruar se Kosova me 36 pikë sivjet ka humbur edhe një pikë në sistemin e vlerësimit të CPI-së (nga 37 sa kishte në vitin 2018 në 36 pikë) dhe si rrjedhojë ka rënë nga pozita e 93-të në atë të 101-të. "Këtë pozitë Kosova e ndan me Bosnjën, Panamanë, Perunë dhe Tajlandën. Me 36 pikë Kosova largohet edhe më tej nga mesatarja globale prej 43 pikësh, përderisa mesatarja evropiane shënon rritje në 66 pikë. Radhitja e dobët e Kosovës në indeksin e sivjetmë iu atribuohet kryesisht institucion-

eve të brishta të sundimit të ligjit, nivelit të lartë të mosndëshkueshmërisë së rasteve të korrupsionit, mungesës së llogaridhënies së zyrtarëve publikë, transparencës së pamjaftueshme dhe ngushtimit të hapësirës për pjesëmarrje qytetare", ka shtuar ai. Sipas Spahisë, një gjetje tjetër

interesante nga krahasimi i rezultateve për vendet e rajonit tregon se i tërë rajoni po kalon nëpër një periudhë stagnimi dhe asnjë nga shtetet e rajonit nuk ka shënuar ngritje në krahasim me vitin e kaluar. "Kapja e shtetit përbën një rënë prej pengesave kryesore në luftimin e korrupsionit dhe vendosjen e

drejtësisë", ka thënë ai. Sipas KDI-së, Kosova duhet të fokusohet urgjentisht në tri fusha në mënyrë që të shënojë përparim: Pavarësinë e sistemit të drejtësisë, luftën kundër korrupsionit dhe në fushën e prokurimit publik, ku kërkohet ngritja e transparencës në të gjitha fazat e procedurës së prokurimit.

Konjufca: Kosovës i duhet mbështetja e Norvegjisë

PRISHTINË, 23 JANAR (ER) - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ka takuar të enjten ambasadorin e Norvegjisë në Kosovë, Jens Erik Grondahl. Në takim u bisedua për marrëdhëniet e deritashme ndërmjet dy vendeve dhe zhvillimet aktuale politike në vend dhe rajon. Kryeparlamentari Konjufca vlerësoi lart mbështetjen e deritashme të Norvegjisë për Kosovën në shumë fusha, ndërsa theksoi domosdoshmërinë që kjo përkrahje të vazhdojë edhe në të ardhmen. Ai ka thënë se perspektiva evropiane e Kosovës është rruga të cilën e përkrahin pa dallim të gjitha institucionet dhe spektri politik në vend, andaj përkushtimi për përmbushjen e detyrave që

përshpejtojnë këtë proces është punë me prioritet.

Ambasadori Grondahl, duke uruar kryeparlamentarin Konjufca për zgjedhjen e tij në krye të Kuvendit të Kosovës, ka thënë se Norvegjia ka qenë afër Kosovës në të gjitha fazat e zhvillimit të saj, duke dhënë kontribut të çmueshëm në këtë drejtim. Ai ka shprehur gatishmërinë e shtetit të tij për ta përkrahur Kuvendin e Kosovës nëpërmjet projekteve që lehtësojnë punën e administratës dhe të ligjvënësve.

Bashkëbiseduesit u pajtuan se ka vend dhe hapësirë që Kosova dhe Norvegjia ta avancojnë bashkëpunimin ndërparlamentar, pastaj në ekonomi, arsim, kulturë dhe sfera të tjera me interes për të dyja vendet.





AMBASADORI AMERIKAN NË BERLIN, RICHARD GRENELL, I DËRGUAR I POSAÇËM I PRESIDENTIT TË SHBA-SË PËR BISEDIME NDËRMJET KOSOVËS DHE SERBISË, KA QËNDRUAR PËR VIZITË NË KOSOVË

Grenelli: Kosova ta heqë taksën, Serbia ta ndalë fushatën kundër njohjeve

Emisari i presidentit Donald Trump për bisedimet ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, Richard Grenell, ka kërkuar të enjten në Prishtinë që Kosova ta heqë taksën 100 për qind ndaj mallrave serbe, kurse nga Serbia ka kërkuar që ta ndalë fushatën kundër njohjeve të Kosovës. Pas takimit me liderët politikë të Kosovës, diplomati amerikan ka thënë se kjo është shumë e rëndësishme të ndodhë nëse palët duan përparime në zhvillimin ekonomik. Ambasadori Grenell ka mohuar se vizita e tij ka pasur për qëllim përfshirjen e ShBA-së në procesin e formimit të qeverisë së re

të Kosovës", ka thënë Grenell pas takimit me Kurtin.

Diplomati amerikan ka mohuar se qëllimi i vizitës së tij është të përzihet në formimin e qeverisë së re. "Ne po e shikojmë këtë çështje nga jashtë, por do t'i them dy gjëra. E para, i thashë z. Kurti se shtetet si Mbretëria e Bashkuar dhe Gjermania kanë pasur përplasje për koalicionet teksa kanë tentuar që ta formojnë qeverinë. Prandaj, i thashë atij se ne po presim të shohim se çfarë do të ndod-

hë. Gjëja e dytë që dëshiroj ta bëj të qartë është se shtytja ekonomike që unë dua ta bëj është shumë e rëndësishme. Krijimi i vendeve të punës, sjellja e bizneseve evropiane dhe amerikane në Kosovë. Njerëzit janë të uritur që të futen dhe që të ndihmojnë që ekonomia e Kosovës të rritet", ka deklaruar Grenell.

Më pas, zyrtari i lartë amerikan, së bashku me ambasadorin Philip Kosnett, kanë takuar edhe liderin

Lidhjes Demokratike të Kosovës, Isa Mustafa, ku ka dhënë të njëjtin mesazh. "Kam ndarë të njëjtin mesazh, se ne në Amerikë nuk jemi të interesuar që të përfshihemi në atë se si duhet të formohet qeveria. Interesimi ynë është zhvillimi ekonomik. Unë ndava vizionin tim që shumë shpejt të arrijmë te momenti i heqjes së tarifave dhe serbët ta ndalin fushatën për çnjohjet. Mendoj se këta janë hapat e ardhshëm", është shprehur Grenell pas takimit me liderin e LDK-së, Isa Mustafa.

Për takimin me diplomatin amerikan ka folur edhe lideri i LV-së, Albin Kurti.

Në profilin e vet në "Twitter", Kurti ka shkruar se me të dërguarin special të presidentit amerikan për dialogun Kosovë - Serbi ka biseduar për nevojën urgjente të zhvillimit ekonomik dhe hapjen e mundësive për punësim. "Prita ambasadorin amerikan Richard Grenell sot në zyrë, bashkë me kryetarin e Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca dhe deputeten Fitore Pacolli. Diskutuam për nevojën urgjente për t'u përqendruar në zhvillimin ekonomik dhe hapjen e mundësive për punësim", ka shkruar Kurti.



**EPOKA
ERE**

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 23 JANAR - I dërguari i posaçëm i presidentit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA), Donald Trump, për bisedimet Kosovë - Serbi, ambasadori Richard Grenell, ka sjellë të enjten në Kosovë mesazhe të rëndësishme për vazhdimin e dialogut Kosovë - Serbi. Pas takimit me liderët politikë të vendit, ai ka deklaruar se Kosova duhet ta heqë taksën 100 për qind ndaj mallrave

serbe, kurse nga Serbia ka kërkuar që ta ndalë fushatën kundër njohjeve të Kosovës.

Të enjten fillimisht ambasadori amerikan ka takuar liderin e Lëvizjes Vetëvendosje, kandidatin për kryeministër, Albin Kurti, nga i cili ka kërkuar të fokusohet te zhvillimi ekonomik. "Është shumë e rëndësishme që nëse duam përparime në zhvillimin ekonomik, tarifa 100 për qind duhet të hiqet. Kjo është diçka që duhet të hiqet në të njëjtën kohë që Serbia duhet ta ndalë fushatën kundër njohjeve



Grenelli: Roli i bizneseve, i rëndësishëm për zgjidhjen e problemeve Kosovë - Serbi

Ambasadori Richard Grenell ka zhvilluar të enjten një takim edhe me përfaqësuesit e biznesit të Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë. Gjatë këtij takimi është thënë se zgjidhja e çështjeve të hapura politike ndërmjet Kosovës dhe Serbisë do t'i ndihmonte të dyja shtetet në aspektin e zhvillimit ekonomik dhe krijimin e vendeve të punës, ku komunitetet e biznesit duhet ta luajnë rolin e tyre në përmblylljen e marrëveshjes përfundimtare ndërmjet të

dyja vendeve. Me këtë rast, ambasadori Grenell ka thënë se administrata e presidentit Trump është shumë e fokusuar në krijimin e vendeve të punës nga bizneset amerikane, duke cekur që komuniteti i biznesit është pjesa më e rëndësishme e zgjidhjes së problemit Serbi - Kosovë. Ai ka thënë se presidenti Trump e ka inkurajuar atë që të përpiqet ta bartë energjinë e administratës së tij në dialogun Serbi - Kosovë pasi, sipas tij, afaristët do të jenë ata të cilët do të krijojnë ngazëllim, mundësi për vende të reja të punës dhe, rrjedhimisht, do t'u japin të rinjve arsye për të qëndruar në Kosovë. Grenelli ka theksuar se është interes i bizneseve ta zgjidhin problemin ndërmjet Kosovës dhe Serbisë dhe se politikanët duhet të lëshojnë rrugë në këtë aspekt, duke shtuar se ideja e tij e fluturimeve komerciale Kosovë - Serbi ka buruar nga një takim i ngjashëm me biznese.

Grenelli darkon me presidentin Thaçi

Ambasadori Richard Grenell, pasi ka arritur në Kosovë, të mërkurën në mbrëmje ka zhvilluar një darkë pune me presidentin e Kosovës, Hashim Thaçi. Me këtë rast, diplomati amerikan ka

deklaruar se Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe presidenti Donald Trump janë të interesuar që t'i zgjidhin problemet dhe çështjet e hapura në bisedimet Kosovë - Serbi. "Presidenti Trump është veçanërisht i përqendruar për zgjidhjen e këtij problemi, jo duke shikuar prapa, jo vetëm duke shikuar argumentet e vjetra. Ne duam të përparojmë në këtë rajon, që në Kosovë të kemi zhvillim ekonomik për njerëzit që e meritojnë këtë. Qytetarët e Kosovës meritojnë të kenë punë dhe ardhmëri të ndritshme. Ajo që po përpiqem të bëj është që të shoh tërë këto çështje që kanë ndikim ekonomik", ka thënë Grenell.

Kurse presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka falënderuar ambasadorin Grenell për marrëveshjen rreth linjës ajrore Prishtinë - Beograd. "Mendoj se është diçka e re, ajo që të tjerët nuk kanë arritur ta bëjnë është duke e bërë ambasadori Grenell dhe administrata e Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Roli i ShBA-së në këtë proces është i jashtëzakonshëm dhe i pazëvendësueshëm. Kam besim të plotë se nën leadershipin e presidentit Trump do të arrijmë deri te marrëveshja finale në mes të shtetit të Kosovës dhe Serbisë, e kjo do t'i ndihmojë shumë zhvil-

Analisti Vela: Nyja e problemit në mes të Prishtinës dhe Beogradit nuk mund të zgjidhet vetëm me marrëveshje politike

Njohësi i çështjeve politike, Blerim Vela, ka komentuar deklarin e ambasadorit Grenell pas takimeve me liderët politikë të Kosovës. Ai ka treguar pse diplomati amerikan po e ndërlihd çështjen e zhvillimit ekonomik me marrëveshjen Kosovë-Serbi. "Administrata e tashme amerikane çdo problem ndërshtetëror e sheh si çështje politike dhe ekonomike. Ne rastin e çështjes izraelite-palestineze administrata amerikane ka propozuar programin ekonomik që përbëhet nga investime prej 50 miliardë dollarësh në territoret palestineze. Në këtë kontekst, duhet kuptuar deklarin e ambasadorit Grenell pas takimeve të sotme me liderët e

vendit, si diskutim për përcaktimin e koston ekonomike të marrëveshjes së ardhshme Kosovë - Serbi", ka deklaruar Vela, duke shtuar se edhe çështja ndërmjet Kosovës dhe Serbisë nuk mund të zgjidhet vetëm me marrëveshje politike. "Sipas kësaj qasje, nyja e problemit në mes të Prishtinës dhe Beogradit nuk mund të zgjidhet vetëm me marrëveshje politike, porse palëve duhet t'u ofrohet iniciativa ekonomike për ta arritur marrëveshjen. Pyetja shtrohet, sa janë të gatshëm liderët institucionalë dhe partitë politike për të bërë një përcaktim të tillë ekonomik në kohën kur nuk ka bashkim të qëndrimeve politike për marrëveshjen e ardhshme me Serbinë?", ka thënë Vela.

limit ekonomik, përparimit, paqes dhe stabilitetit", ka thënë Thaçi.

Pas Kosovës, ambasadori Grenell do ta vizitojë edhe Serbinë, ku do të takohet me presidentin serb Aleksandër Vuçiq. Ambasadori Grenell ka vizituar rajonin dy ditë

pasi bashkë me këshilltarin e Sigurisë Kombëtare, Robert O'Brien, ndërmjetësoi marrëveshjen ndërmjet Kosovës dhe Serbisë për rihapjen e linjës ajrore Prishtinë - Beograd, në një përpjekje për përmirësimin e lidhjeve ekonomike midis dy vendeve.

Grenell: Trumpi s'do të lejojë që negociatat Prishtinë - Beograd të zgjasin shumë

Pas vizitës që ka zhvilluar në Prishtinë, ambasadori Richard Grenell ka vizituar edhe Beogradin. Gjatë takimit me presidentin serb Aleksandër Vuçiq, ambasadori Grenell ka thënë se ekziston një afat i shkurtër kohor për t'i zgjidhur marrëdhëniet Prishtinë - Beograd. Ai ka theksuar se Trumpi nuk do të humbasë kohë dhe se nuk do të lejojë që zgjidhja të zgjasë shumë nëse nuk ka përparim.



Kosovës po i ikin qytetarët

Prishtinë, 23 janar - Më shumë se 220 mijë qytetarë të Kosovës kanë emigruar në dekadën e fundit, thuhet në të dhënat e Agjencisë së Statistikave të Kosovës. Kjo shifër, sipas demografëve dhe përfaqësuesve të shoqërisë civile, konsiderohet mjaft shqetësuese. Numri më i madh i qytetarëve të cilët kanë emigruar nga Kosova gjatë periudhës 2010-2018 u shënuar në vitin 2015, kur nga Kosova u larguan mbi 75 mijë qytetarë. Më pas në vitin 2016 dhe 2017, emigrimi kishte shënuar rënie, ndërsa në vitin 2018 ka pasur përsëri rritje të emigrimit, përkatësisht mbi 28 mijë persona vendosën të ikin nga vendi. Agjencia e Statistikave të Kosovës nuk i ka të publikuara ende shifrat për vitin 2019.

Në të dhënat zyrtare të emigrimit janë të përfshira emigrimi në mënyrë të rregullt dhe ai i parregullt. Vendet ku qytetarët e Kosovës kanë emigruar më së shumti gjatë viteve 2010-2018 janë Gjermania, Franca, Austria, Kroacia e shtete të tjera. Për peri-

udhën 2016-2018 vlerësohet se Kosova ka humbur rreth 2 për qind të popullsisë së vendit.

Demografi Rifat Blaku, në një prononcim për "Radion Evropa e Lirë", e quan shqetësues numrin e qytetarëve të cilët po e lëshojnë Kosovën. Më shqetësuese, thotë ai, është se vendin po e braktis pjesa më vitale e popullsisë, pra të rinjtë që, sipas tij, janë më produktivë dhe të shkolluar. "Është një humbje e madhe dhe një çrregullim i madh në strukturën demografike, biologjike dhe për këtë është koha jo vetëm aktuale për shqyrtim e diskutim, por edhe për krijimin e një aksioni efikas e praktik, politik e institucional, për ta krijuar një politikë të migracionit, e cila do të nisë nga trajtimi që migrimi është i kontrolluar, i menaxhuar, të jetë i përkohshëm që t'i valorizojë aspektet pozitive, meqë kanë një kapital të madh dhe t'i zvogëlojnë efektet negative të migracionit", thotë Blaku.



Gjermania, Sllovenia dhe Kroacia, sipas një raporti të fundit mbi migrimin të Ministrisë së Punëve të Brendshme, janë shtetet që rezultojnë me një rritje të dukshme të pranimit të qytetarëve kosovarë për qëllime punësimi gjatë vitit 2018.

Ndërkohë, më 1 mars 2020, pritet të hyjë në fuqi Ligji gjerman për fuqinë punëtore, i cili rregullon ardhjen e fuqisë punëtore nga vendet jashtë Bashkimit Evropian. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, Demush Shasha nga Instituti i Kosovës për Politika Evropiane (EPIK) thotë se mund të ketë një fluks edhe më të madh të të rinjve

nga Kosova dhe vendet më pak të zhvilluara që do ta lëshojnë vendin. "Ky ligj lehtëson lëvizjen e njerëzve, lëvizjen e punëtorëve për në Gjermani, ka potencial për një fluks të madh, do të presim dhe do ta shohim ndikimin që do ta ketë ky ligj", thotë Shasha.

Disa të rinj të anketuar nga Radio Evropa e Lirë thonë se arsyeja se pse do të ikin është mungesa e perspektivës në Kosovë.

Numri në rritje i të rinjve për të lëshuar Kosovën, thotë Demush Shasha nga EPIK, ka ardhur si pasojë e zhvillimeve jo të mira ekonomike, politike dhe sociale që po e përcjellin Kosovën.

Në një anketë të Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP), të quajtur "Pulsi publik", e cila ishte publikuar në vitin 2019, pati vënë në pah se më shumë se gjysma e të gjithë të anketuarve në Kosovë kanë deklaruar se çështjet më të mëdha me të cilat bal-

lafaqohet Kosova janë të lidhura me korrupsionin dhe kushtet socio-ekonomike.

Rreth 50 për qind e të anketuarve janë deklaruar ose të pakënaqur ose shumë të pakënaqur me drejtimin aktual politik të Kosovës. Po sipas kësaj ankete të UNDP-së, thuhet se afërsisht gjysma e popullsisë nuk i sheh proceset demokratike në Kosovë nën dritën pozitive dhe as për ekonominë nuk ka pikëpamje pozitive.

Në tre vjetët e fundit edhe bizneset në Kosovë kishin theksuar se, edhe përkundër nivelit të lartë të papunësisë në Kosovë, kanë pasur mungesë të punëtorëve. Ata kishin thënë se kanë pasur probleme për gjetjen e punëtorëve në sektorin e ndërtimitarisë, në hotelieri dhe në disa sektorë ku punohen punë sezonale.

Numri i qytetarëve të Kosovës që jeton jashtë vendit, sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, deri në fund të vitit 2018 vlerësohet të jetë mbi 850 mijë banorë.



Kryetari Elezaj takohet me imzot Dodë Gjergjin

KLINË, 23 JANAR (ER) - Kryetari i Komunës së Klinës, Zenun Elezaj, i shoqëruar nga bashkëpunëtorë të komunës, kanë pritur në takim ipeshkvin e Kosovës, Imzot Dodë Gjergjin, me të cilin kanë biseduar për sfidat, nevojat dhe mundësitë e bashkëpunimit. Kryetari Elezaj ka falënderuar imzot Dodë Gjergjin për vizitën e realizuar, duke thënë se insti-

tucionet komunale do të jenë çdoherë të gatshme për bashkëpunim me institucionet fetare dhe palët e tjera që shprehin interes. Në anën tjetër, ipeshkvi Gjergji ka shprehur falënderim për pritjen dhe bashkëpunimin e realizuar deri më tash nga Komuna, duke theksuar se diversiteti fetar është pasuri e jona të cilën duhet ta ruajmë si vlerë e popullit të Kosovës.

Muharremaj me përfaqësuesit e 'Hidroregjionit' bisedojnë për furnizimin me ujë të pijshëm

SUHAREKË, 23 JANAR (ER) - Kryetari i Komunës së Suharekës, Bali Muharremaj, ka pritur në takim përfaqësuesit e "Hidroregjionit" si dhe të CDI-së, me të cilët ka biseduar për furnizimin me ujë të gjithë qytetarëve të kësaj komune. Në këtë takim Muharremaj ka folur për shtrirjen e rrjetit të ujësjellësit në territorin e Suharekës. "Ka përfunduar rrjeti i

ujësjellësit në Nepërbisht, në përfundim e sipër është në Maqitevë dhe po pajtohemi që do të fillojë zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit edhe në Reqan. Dy basene të ujit do të ndërtohen në Reqan dhe Papaz. Në bashkëpunim me organizatën e CDI-së do të fillojë realizimi i projektit për impiantin e ujërave të zeza", ka thënë Muharremaj.



Mitrovica nderon Isa Boletinin në 104-vjetorin e rënies

MITROVICË, 23 JANAR (ER) - Me rastin e 104-vjetorit të rënies së heroit të kombit, Isa Boletini, kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, nënkryetari Faruk Mujka, drejtorët komunalë dhe përfaqësues nga Shoqata e Veteranëve të Luftës së UÇK-së, kanë bërë homazhe përkujtimi te kulla e Isa Boletinit dhe shtatorja e tij në sheshin e qytetit. Fillimisht përfaqësuesit e komunës kanë

vizituar kullën e Isa Boletinit, ku të gjithë bashkërisht vendosën buqetë me lule, për të vazhduar më pastaj nderimin te shtatorja e vendosur në qendër të qytetit. Me këtë rast, kryetari Bahtiri ka theksuar se Isa Boletini është një atdhetar që ka bashkuar trojet shqiptare dhe ka dhënë kontribut të jashtëzakonshëm për pavarësinë e Shqipërisë dhe për lirinë e trojeve shqiptare.



Komuna e Prizrenit vazhdon punimet për mirëmbajtjen e rrugëve lokale



PRIZREN, 23 JANAR (ER) - Në kuadër të mirëmbajtjes së rrugëve lokale, Komuna e Prizrenit është duke vazhduar punimet për përmirësimin e gjendjes aktuale të rrugëve, trotuarëve dhe hapësirave të tjera publike, në të cilat janë shfaqur dëmtime të cilat shkaktojnë vështirësi për zhvillimin e lirshëm të komunikacionit dhe lëvizjen e qytetarëve.

Komuna e Prizrenit ka bërë me dije se intervenimet tashmë

janë bërë në rrugët "Saraçët", "Hysen Rexhepi" dhe në hapësirën pranë stadiumit të qytetit, ku dëmtimet në rrugë janë mbuluar përkohësisht me kubëza, ndërsa me përmirësimin e kushteve atmosferike do të bëhet edhe shtrimi me asfalt. "Aktivitetet punuese do të vazhdojnë edhe në ditët në vijim në rrugë të tjera të qytetit, duke u bazuar në raportimet dhe kërkesat e qytetarëve të Prizrenit", ka njoftuar kjo komunë.

ShBA-ja i dhuron Shërbimit Korrektues pajisje në vlerë prej 100 mijë eurosh

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 23 DHJETOR - Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës, Nehat Thaçi, ka pritur në takim zëvendësndihmëssekretarin e ShBA-së, Jorgan Andrews, me të cilin ka nënshkruar një memorandum bashkëpunimi, me ç'rast Byroja për Çështje Ndërkombëtare të Narkotikëve dhe Zbatimit të Ligjit (INL) i dhuroi Shërbimit Korrektues të Kosovës pajisje me vlerë rreth 100 000 dollarësh.

Shërbimi Korrektues i Kosovës në kuadër të bashkëpunimit të vazhdueshëm që gëzon tash e disa vite në fushën e trajnimeve nga Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, në veçanti nga Programi ICITAP&INL, ka pranuar donacionin e katërt me radhë: një kamion, 25 kompjuterë, dy laptop, 100 llamba elektrike të dorës, 300 palë pranga, si dhe pajisje të ndryshme të sigurisë, pajisje këto të cilat mbështesin fuqishëm reformën e zhvillimit të shërbimit korrektues, duke aspiruar në

ndërtimin e një sistemi funksional, të besueshëm, efektiv dhe të vetëqëndrueshëm.

Kryeministri në detyrë, Ramush Haradinaj, ka pritur të enjten në takim zëvendësndihmëssekretarin e Shtetit nga Byroja për Çështje Ndërkombëtare të Narkotikëve dhe Zbatimit të Ligjit, Jorgan K. Andrews, me të cilin ka biseduar për partneritetin e Kosovës me ShBA-në në luftë kundër trafikimit të narkotikëve, krimin të organizuar dhe korrupsionit.

Haradinaj në këtë takim ka theksuar se Kosova ka shënuar përparim të rëndësishëm për fuqizimin e sektorit të sigurisë, veçmas duke forcuar Policinë, Prokurorinë dhe gjykatat dhe është partnere e denjë edhe për operimet globale në këtë fushë. "E falënderova z. Andrews për ndihmën e pakursyer që ShBA-ja ka dhënë dhe po vazhdon të japë për forcimin e institucioneve të vendit dhe kërkova nga ai që ky partneritet të vazhdojë edhe në të ardhmen, duke shprehur gatishmërinë e institucioneve tona karshi përgjegjësi të përbashkëta", ka thënë Haradinaj



pas takimit. Ai ka shtuar se Kosova ka arritur të ndërtojë institucione kredibile dhe të avancojë profilizimin e tyre falë edhe partneritetit me ShBA-në. "Sot jemi të gatshëm të qëndrojmë në krahë me vendet aleate, për sigurimin e paqes dhe stabilitetit, jo vetëm për qytetarët tanë", ka deklaruar Haradinaj. Edhe sekretari i përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Brendshme, Lulzim Ejupi, ka prit-

ur në takim zëvendësndihmëssekretarin e Shtetit nga Byroja për Çështje Ndërkombëtare të Narkotikëve dhe Zbatimit të Ligjit, Jorgan K. Andrews, të cilin e ka informuar për situatën e përgjithshme të sigurisë në Kosovë, për angazhimet e vazhdueshme të Ministrisë së Punëve të Brendshme, për forcimin e sundimit të rendit dhe ligjit, për luftën kundër korrupsionit, krimin të organizuar dhe

narkotikëve. "MPB-ja në kuadër të misionit të vet do ta vazhdojë luftën pa kompromis kundër krimin të organizuar, duke ndërmarrë veprime konkrete në këtë aspekt. Ne kemi hartuar dokumente strategjike sa i përket luftës kundër narkotikëve dhe jemi të përkushtuar që vazhdimisht të angazhohemi për parandalimin e këtyre dukurive me të cilat ballafaqohen shumë shtete të botës", ka theksuar Ejupi.

PDK-ja: Komuna e Prishtinës ta tërheqë lejen për kushtet e ndërtimit në Badovc

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 23 JANAR - Deputetja e Kuvendit të Kosovës nga radhët e PDK-së, Eliza Hoxha dhe asamblisti i Komunës së Prishtinës nga radhët e kësaj partie, Leotrim Retkoceri, kanë mbajtur të enjten një konferencë për media. Në këtë konferencë deputetja Hoxha dhe asamblisti Retkoceri kanë kërkuar nga Komuna e Prishtinës që ta tërheqin lejen për kushtet e ndërtimit për kompaninë e cila ka planifikuar aktivitetin banesor në liqenin e Badovcit dhe t'i zbatojnë të gjitha ligjet në fuqi të cilat e përcaktojnë këtë zonë të mbrojtur me ligj. "Ftojme kryetarin e Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti, Drejtorinë e Urbanizmit dhe Drejtorinë e Inspeksionit, që të anulojnë dhënien e pëlqimit për kushtet ndërtimore të lëshuara në afërsi të liqenit të Badovcit. Të kthehet diskutimi në Kuvendin Komunal të Prishtinës ku do të mund të sqarohen të gjitha rrethanat dhe në fund të vendoset në përputhje me ligjet dhe interesat e qytetarëve të Prishtinës", ka thënë Retkoceri. Ai ka njoftuar se tashmë nënshkrimet e nevojshme të asamblistëve për të thirrur seancë të jashtëzakonshme janë dorëzuar në komunë sipas procedurës së

kërkuar me ligj. "I bëjmë thirrje Komunës së Prishtinës që sa më parë ta caktojë datën dhe orën e seancës për mbrojtje të liqenit të Badovcit", ka thënë Retkoceri. Deputetja e Kuvendit të Kosovës nga radhët e PDK-së, Eliza Hoxha, ka kërkuar nga Ministria e Planifikimit Hapësinorë dhe Komuna e Prishtinës që të sqarojnë çdo bazë ligjore në lidhje me situatën e krijuar në liqenin e Badovcit. "Me ligjet aktuale në fuqi, Badovci është një zonë e mbrojtur ujore. Kjo nënkupton që aty nuk duhet të lejohen ndërtime, përfshirë edhe zonën e dytë, duke e ruajtur qëllimin primar të liqenit, që është furnizimi me ujë të pijes për qytetarët e Prishtinës", ka thënë deputetja Eliza Hoxha.

Deputetja Hoxha ka thënë se Plani Zhvillimor Urban në vitin 2012 parasheh dhe trajton Badovcin dhe Gërmënë si park regjional, që në të ardhmen mund të përcillet me funksione rekreative, por asnjëherë rezidenciale. "Ajo që është e rëndësishme të theksohet, është se Plani Zhvillimor Urban, si organ që përcakton zonën zhvillimore urbane, për 10 vjet nuk përfshinë këtë zonë të vilave brenda kufirit urban. Kjo nënkupton që zona në fjalë nuk e ka statusin e tokës ndërtimore dhe potenciale për zhvillim dhe ndërtim sepse është



e pozicionuar jashtë unazës së jashtme të Prishtinës e cila e përkufizon një pjesë të kufirit urban", ka thënë Hoxha. Ajo ka treguar se të dyja këto plane janë miratuar pas vendimit të shpalljes së Badovcit zonë të mbrojtur. Plani rregullues urban për zonën Prishtina e Re (2017) nuk e përfshinë këtë zonë brenda territorit të tij. Ky plan është reviduar sërish për shkëmbimin e disa pronave me interes publik në vitin 2019. Hoxha ka bërë me dije se

deri në miratimin e hartës zonale plani rregullues urban vazhdon të mbetet instrumenti bazë përmes të cilit lëshohen kushtet urbanistike dhe ndërtimore. "Pyetja që kemi për Komunën e Prishtinës, se mbi cilën bazë juridike komuna i ka lëshuar këto kushte? Prandaj, unë i përgëzoj asamblistët e PDK-së për iniciativën, por edhe të gjithë asamblistët e tjerë që e kanë mbështetur këtë kërkesë për seancë të jashtëzakonshme. Uroj që kjo të

caktohet sa më shpejt dhe të shpëjgohet të gjitha paqartësitë në lidhje me këtë shqetësim qytetar. Më e rëndësishmja, ne do të kërkojmë që të zbatohet secili ligj në lidhje me këtë çështje", ka përfunduar Hoxha. Seanca e jashtëzakonshme në Komunën e Prishtinës për liqenin e Badovcit, e iniciuar nga asamblistët e PDK-së dhe e mbështetur nga asamblistët e partive të tjera, pritet të mbahet javën e ardhshme.

MTI-ja dhe ADA, marrëveshje bashkëpunimi për t'i ndihmuar ndërmarrjet e vogla dhe të mesme

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 23 JANAR - Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Endrit Shala, ka nënshkruar të enjten marrëveshje bashkëpunimi me shefin e zyrës së Agjencisë Austriake për Zhvillim (ADA) në Kosovë, Gunther Zimmer. Marrëveshja do t'i shërbejë sektorit privat me qëllim të krijimit të masave lehtësuese, të cilat do ta zhvillojnë edhe më tutje sektorin privat dhe ngritjen vetëdijën ndërmarrëse në Kosovë. Ministri Shala ka thënë se është me rëndësi të përmendet se masat janë përshtatur për të nxitur ndryshime në sistem të funksionimit sa më të mirë të ndërmarrjeve, në metodologjinë gjithëpërfshirëse të sistemit të tregut, duke lehtësuar aktivitetet e palëve të interesit dhe sigurimin e ndikimit sistematik. "Projekti, si i tillë, do të tentojë që t'i rrisë rezultatet e të ardhurave më të larta dhe mundësi të

punësimit në sisteme më të qëndrueshme të tregut. Projekti do të kontribuojë në fuqizimin e konkurrueshmërisë së kompanive të sektorit privat dhe në rritjen e të ardhurave të tyre përmes qasjes së qëndrueshme në treg dhe lidhjeve më të fuqishme rajonale dhe ndërkufitare. Masa të tilla rrisin produktivitetin dhe profitabilitetin për shkak të shërbimeve të diversifikuara dhe të përmirësuara të zhvillimit dhe digjitalizimit të biznesit. Aktorët kyçë institucionalë do të mbështeten për të përmirësuar dhe përshtatur shërbimet dhe politikat e tyre, për të siguruar qëndrueshmëri dhe përfshirje më të madhe në të gjitha sferat e ndërmarrësisë", ka thënë Shala.

Ky projekt ka për qëllim nxjerrjen e rezultateve, duke ofruar mjete dhe shërbime të reja digjitale që do të jenë në dispozicion dhe të përdoren nga Ndërmarrjet Mikro, të Vogla dhe të Mesme të Kosovës (NMVM).



Po ashtu, NVM-të e Kosovës duhet ta përmirësojnë nivelin e tyre të digjitalizimit dhe krijojnë lidhje tregu dhe konsulentët e bizneseve të ofrojnë shërbime të digjitalizimit, të cilat janë efektive dhe të përbalueshme për NVM-të. "Pra, Ministria e

Tregtisë dhe Industrisë edhe më tutje do të vazhdojë ta mbështesë sektorin privat dhe, për rrjedhojë, ta ndryshojë edhe më tutje sistemin e funksionimit të NVM-ve kosovare, me qëllim të zhvillimit ekonomik, qasjes në tregje të huaja dhe rritjen e

punësimit. MTI do të jetë derë e hapur për të gjithë mekanizmat ndërkombëtarë dhe vendorë, që së bashku mund të krijojnë një ambient miqësor dhe të përshatshëm për zhvillimin e shpirtit ndërmarrës", ka thënë ministri Shala.

'Termokos'-i do ta zgjerojë rrjetin e ngrohjes në 50 për qind të lagjeve të Prishtinës

PRISHTINË, 23 JANAR (ER) - Kryeshefi ekzekutiv i 'Termokos'-it, Arsim Fetahu, në një konferencë për media ka bërë me dije të enjten se furnizimi me ngrohje gjatë vitit 2019 ka qenë më i mirë se në vitet para-prake. Ai ka deklaruar se sivjet do të ketë zgjerim të rrjetit të ngrohjes në 50 për qind të lagjeve në Prishtinë, nga 28 për qind sa ishte deri më tani. "Viti i kaluar ka qenë më i suksesshmi në historinë e 'Termokos'-it, duke pasur parasysh të arriturat të cilat do t'i shpalosim. Gjatë vitit 2019 furnizimi me ngrohje ka qenë shumë i mirë, ku pjesa dërrmuese e konsumatorëve tanë janë të kënaqur me shërbimet e ngrohjes. Gjithashtu, dallim këtë vit ka bërë edhe furnizimi kualitativ i ngrohjes së

Kodrës së Diellit, i cili deri tash ka pasur probleme të theksuara mirëpo, për fat të mirë, është rregulluar. Prodhimi i energjisë termike ka qenë 232.246 MWh, ka rritje 5 për qind në vitin 2019 më shumë se në vitin 2018, që ka qenë prodhimi më i madh që ka qenë ndonjëherë në 'Termokos'. Liferimi i energjisë termike ka pasur rritje për 9.6 për qind në raport me vitin 2018", është shprehur Fetahu. Sipas tij, humbjet e energjisë gjatë vitit 2019 kanë pasur rënie nga 10 për qind në 8 për qind, që është shumë e rëndësishme për përmbushjen e nevojave në aspektin teknik. Fetahu ka thënë se lagjet që do të jenë prioritet i 'Termokos'-it për vitin 2020 janë fillimisht 'Ulpiana', 'Dardania' dhe 'Mati 1'.



ATK-ja ndan mirënjohje për Klubin e Prodhuesve të Kosovës

PRISHTINË, 23 JANAR (ER) - Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) ka ndarë mirënjohje për Klubin e Prodhuesve të Kosovës për bashkëpunimin gjatë këtyre viteve. Prodhuesit e Kosovës janë tatimpaguesit më të rregullt dhe më të mëdhenj në vendin tonë. Ndërkaq, Klubi

i Prodhuesve të Kosovës ka kënaqësinë që të jetë bashkëpunëtor dhe të kontribuojë për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit tonë. Klubi i Prodhuesve të Kosovës ka njoftuar se edhe më tutje do të vazhdojë të avokojë për ndryshime në politika duke

përfaqësuar prodhuesit vendorë, ta rrisë bashkëpunimin mes prodhuesve vendorë dhe institucioneve shtetërore si dhe ta ngrehë vetëdijen e qytetarëve për rëndësinë e konsumit të prodhimeve vendorë dhe t'i promovojë produktet 'Made in Kosova'.



Shtrenjtohet çimento në Kosovë për 24.4 për qind, reagojnë bizneset

Prodhuesit e betonit të enjten në një konferencë për media, të organizuar nga Oda e Afarizmit të Kosovës, kanë shprehur shqetësimet e tyre ndaj prodhuesit të vetëm të çimentos në Kosovë, "Sharrcem", në lidhje me rritjen e çmimit të çimentos brenda dhjetë muajve për rreth 24.4 për qind

EPOKA ERE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 23 JANAR - Përfaqësues të Odës së Afarizmit të Kosovës (OAK) kanë mbajtur të enjten konferencë për media lidhur me ngritjen e çmimit të çimentos për rreth 25 për qind. Përfaqësues të bizneseve kanë shprehur shqetësimet e tyre dhe kundërshtimin ndaj lëvizjeve dhe ndryshimeve të çmimeve

që kanë ndikim të drejtpërdrejtë në aktivitetin e tyre ekonomik. Bazuar në reagimet e bizneseve, Oda e Afarizmit të Kosovës (OAK) ka shprehur mbështetje në të drejtën e bizneseve për shqetësimet e tyre të argumentuara.

Naim Mahmutaj nga OAK-u në një konferencë për media ka deklaruar se ngritja e çmimit 24.4 për qind është e qartë se "Sharrcem" është duke e për-

dorur rolin dominues në treg që t'i ngrehë në mënyrë arbitrare çmimet e çimentos. "Kjo sjellje lë të hapur mundësinë në vazhdimësi të kemi abuzim me pozitën dominuese në treg që gëzon kjo kompani", u shpreh Mahmutaj. Ai ka thënë se ngritja e çmimeve ka ndodhur pa ndonjë paralajmërim paraprak. Sipas tij, ngritja është e papërbalueshme për bizneset dhe ka ndikim drejtpërdrejt te kon-

sumatorët.

Të pranishëm në këtë konferencë për media ishin edhe përfaqësuesit e sektorit të ndërtimit, të cilët theksuan se shtrenjtimi i çimentos është i padrejtë. Prodhuesi i betonit, Bujar Avdyli, tha se kjo ngritje e çmimeve nuk do t'i prekë vetëm prodhuesit, por do të ndikojë në shtrenjtimin e çmimit të betonit që do të jetë vetëm në dëm të qytetarëve të Kosovës.

Bizneset të cilat furnizohen me lëndë të parë nga "Sharrcem" kanë theksuar se çmimi i çimentos para muajit mars të vitit 2019 ka qenë 60.89 euro, ndërsa pas kësaj date është rritur në 68.44 euro. Nëntë muaj më pas

çmimi është ngritur prapë, duke kaluar në shifrën 75.75 euro.

Kohë më parë Oda e Afarizmit të Kosovës kishte bërë kërkesë tek Autoriteti Kosovar i Konkurrencës që të parandalojë që gjëra të tilla të mos ndodhin. Oda e Afarizmit po ashtu i ka dërguar kërkesë kompanisë "Sharrcem", për ta shpjeguar këtë rritje të çmimit, por ata janë shprehur se ky vendim është marrë duke u bazuar në ekonominë e tregut të lirë. OAK-u, gjithashtu, ka bërë thirrje që të angazhohen edhe organet e shtetit si Ministria e Tregtisë dhe Industrisë që ta verifikojnë cilësinë e betonit, por edhe të verifikohet gjendja.



Përfaqësuesit e OAK-ut takohen me përfaqësuesen e Ambasadës së Zvicrës

PRISHTINË, 23 JANAR (ER) - Përfaqësuesit e Odës së Afarizmit të Kosovës janë pritur të enjten në takim nga zëvendëshefja e misionit të Ambasadës së Zvicrës, Pauline Menthonnex - Gacaferri. Qëllimi i këtij takimi ishte njoh-

ja e të dyja palëve dhe gjetja e mundësive të bashkëpunimit reciprok në të ardhmen e afërt. "Krijimi i kanaleve të komunikimit me atashetë ekonomike të ambasadave është konsideruar më se e nevojshme, duke pasur

parasysh që OAK-u përfaqëson një numër të madh të bizneseve, e të cilat bashkëpunojnë apo kanë interes që të gjejnë partnerë potencialë, me qëllim të zgjerimit të tregut të tyre", është theksuar në njoftimin e OAK-ut.



Sa është realizuar plani strategjik i arsimit në Kosovë?



Ismajl KURTESHI

Në konferencën e organizuar nga Rrjeti Kosovar për Edukim dhe Punësim (KEEN), më 20 janar 2020 në Prishtinë, u bë vlerësimi i zbatimit, të tri viteve të para (2017-2019), të Planit Strategjik për arsimin në Kosovë 2017 - 2021.

PSAK-u (Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë), përcakton shtatë objektivat strategjike që synojnë: gjithëpërfshirjen, përmirësimin e cilësisë dhe rritjen e llogaridhënies në të gjitha nivelet e arsimit në Kosovë.

Përfaqësuesi i Bashkimit Evropian, që ishte edhe diskutuesi i parë i kësaj konference, fjalën e tij e filloi me konstatimin se gjatë tri vjetëve të fundit (2017-2019), vitet që ishim objekt i diskutimit të kësaj konference, "... arsimi në Kosovë nuk ka shënuar përparim... pra ka stagnuar...". Diskutuesi i njëjtë, përveç të tjerash, tha se në Institucionet e Arsimit të Lartë në sektorin privat në Kosovë po lëshohen diploma pa vlerë.

Se në fushën e arsimit nuk ka pasur përparim gjatë kësaj periudhë dëshmojnë edhe të gjeturat e analizës së KEEN-së të financuara nga Bashkimi Evropian dhe të menaxhuara nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë. Në këtë shkrim do t'i gjeni vetëm disa nga të gjeturat kryesore të

kësaj analize.

Analiza fillon me konstatimin se: pjesëmarrja e fëmijëve në edukimin parashkollor është e ulët. Përafërsisht kështu ishte gjendja me përfshirjen e parashkollore edhe para tri vjetëve.

Sipas analizës së lartpërmendur, fëmijët me nevoja të veçanta dhe fëmijët me talente të veçanta mbeten kategori të marginalizuara në arsimin parauniversitar. Gjendja e këtyre kategorive ishte e njëjtë edhe para tri vjetëve.

Në analizën e lartpërmendur konstatohet se: Investimet në përmirësimin e cilësisë në arsim janë shumë të vogla. Ky është një defekt kronik në fushën e arsimit në Kosovë dhe një ndër shkaktarët kryesorë të gjendjes së krijuar në arsim, edhe pse në Rezolutën e Kuvendit të Kosovës për Arsimin, të aprovuar me 9 shkurt 2017, kërkohet rritje e investimeve.

Legjislacioni si në arsimin parauniversitar dhe si në arsimin e lartë duhet të ndryshohet, plotësohet dhe harmonizohet. Gjendja në këtë fushë nuk ka shënuar asnjë përparim gjatë tri vjetëve të fundit me të cilët është marrë analiza. GIZ ka dalë me propozime konkrete si të rregullohet kjo çështje por, për shkak të mosangazhimit të MASHT-it dhe pengesave kushtetuese që parashohin shumicën e dyfishitë (veton e komuniteteve pakicë), në këtë drejtim nuk ka ndryshuar asgjë.

Procesi i vlerësimit të performancës të mësimdhënësve nuk është realizuar sipas planit të veprimit të PSAK-së. Sipas kësaj

analize, deri në qershor të vitit 2019 vetë rreth 2 për qind e mësimdhënësve i janë nënshtruar procesit të vlerësimit të performancës (për periudhën 2017-2019 ka qenë e planifikuar të realizohet 60 për qind e vlerësimit të performancës. As procesi i licencimit të mësimdhënësve, sipas sistemit të gradimit nuk është shënuar asnjë sukses. Gjendja është përafërsisht e njëjtë edhe me shkallën e vlerësimit të jashtëm e cila është rreth 4 për qind edhe pse, sipas këtij plani, është dashur të jetë rreth 60 për qind. Edhe zbatimi i kurrikulës së re është përcjellë me sfida të shumta, përfshirë mungesën e mekanizmave të mbikëqyrjes, përkrahjes dhe llogaridhënies në procesin e zbatimit të kurrikulës.

Në nivel të vendit janë angazhuar 645 koordinatorë të cilësisë, por shumë prej tyre kryejnë punë të tjera, kështu që angazhimi i tyre nuk ka ndikuar mjaftueshëm në ngritjen e cilësisë. Puna që po e kryejnë inspektorët e arsimit nuk është e kënaqshme edhe pas miratimit të ligjit të ri për Inspektoratin e Arsimit dhe rritjes së numrit të inspektorëve.

Lidhja e arsimit profesional me tregun e punës, sipas analizës, vazhdon të mbetet problem serioz në sferën e arsimit si që është problem edhe mungesa e shërbimeve në sferën e këshillave për orientimin në karrierë. Këshillat industriale për arsim profesional që kanë për qëllim rritjen e bashkëpunimit ndërmjet shkollave profesionale dhe bizneseve kryesisht kanë mbetur të pathemeluara në komunat tona.

Pajisja me teknologji arsimore dhe mjete mësimore, digjitalizimi i shërbimeve arsimore, shfrytëzimi i burimeve online, krijimi i ekipeve për identifikimin e nevojave të shkollave për teknologji arsimore, po ashtu janë objektiva të porealizuara.

Ngecja e vazhdueshme në fushën e zhvillimit profesional dëshmon se institucionet që kanë rol dhe përgjegjësi në këtë fushë nuk kanë arritur ta kuptojnë rëndësinë e zhvillimit të mësimdhënies në funksion të ngritjes së cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies. Për pasojë veprimet kryesore janë orientuar vetëm në përmbushjen e kërkesave administrative. Në vitet e fundit MASHT-i e ka zvogëluar buxhetin për trajnimin e mësimdhënësve, kështu është zvogëluar numri i mësimdhënësve të përfshirë në trajnime dhe numri i orëve të trajnimeve si dhe formave të tjera të zhvillimit profesional.

KEEN në këtë analizë i ka identifikuar edhe të metat në tekste shkollore në Kosovë siç janë:

1. Mungesa e harmonizimit të teksteve me kurrikulën e re;
2. Ngarkesa e madhe e teksteve shkollore me tekste të gjata, fakte, formula, kapituj etj;
3. Përmbajtja me fakte të gabuara dhe koncepte të padefinuara;
4. Mungesa e balancimit të kapitujve;
5. Struktura joadekuate të përmbajtjeve;
6. Mungesa e lidhjes së njohurive dhe përvojave më të hershme të nxënësve/ studentëve me tekste etj.

Për ta kuptuar gjendjen në

arsimin e lartë mjaftojnë të dhënat se raporti profesor - student në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë është 1 me 55, kurse në institucionet private 1 me 32. Kur kësaj ia shtojmë edhe faktin se shumë mësimdhënës të këtyre institucioneve punojnë në dy, tri e më shumë vende pune, se mungojnë tekstet dhe kushtet për punë, kushte për hulumtime shkencore nuk ka. Në shumë Institucione të Arsimit të Lartë që zhvillohet mësim në programet e paakredituara del se gjendja në arsimin e lartë është e rëndë. Këtu duhet të përmendet edhe e vërteta e hidhur se brenda periudhës që është analizuar, AKA (Agjencia Kosovare e Akreditimit) është përjashtuar nga EQAR-i (Institucion Evropian për Vlerësimin e Cilësisë).

As në fushën e hulumtimeve shkencore nuk ka përparim. Kosova përballet me mungesën e rregulloreve për kërkim shkencor. Kosovës i mungon Këshilli Kombëtar i Shkencës dhe zbatimi i një programi të përditësuar për shkencë. Po ashtu, buxheti i ndarë për kërkime shkencore është i kufizuar dhe nuk i plotëson nevojat e komunitetit kërkimor në vend.

Të dhënat (analizat) e publikuara nga KEEN (Rrjeti Kosovar për Arsim dhe Punësim), një pjesë e të cilave u prezantuan në këtë shkrim, me qëllim të njoftimit të opinionit me të gjeturat e kësaj analizë, janë vërejtje serioze për institucionet dhe qytetarët e këtij vendi, që kërkojnë angazhim shumë të madh dhe investime të mëdha në fushën e arsimit me qëllim të daljes nga kjo situatë.

Koordinatori Hoti u dhuron 2 394 libra nxënësve fitues të garës në Prizren

PRIZREN, 23 JANAR (ER) - Koordinatorit Nacional për Kulturë, Rini dhe Sport, Rexhep Hoti, të enjten në një ceremoni madhështore në Prizren ka bërë ndarjen e shpërblimeve për 364 fitues të nivelit komunal të cilët morën sete librash në vlerë prej 50 eurosh. Këto shpërblime u ndanë në kuadër të zbatimit të Programit Nacional për Rininë, ku morën pjesë 29 komuna në të gjitha nivelet e garës nacionale në Kreativitet Kulturor e Mendim Kritik si dhe në Dituri. "Askund tjetër përpos në Prizren nuk ka pasur më shumë çmime për nivelin e garave komunale. Kemi gjithsej 364 nxënës. Kjo është puna dhe mundi juaj. Ju të gjithë mund të jeni në gjendje të ndryshme

sociale, mirëpo dua t'ju them, si mendje e ardhshme e Republikës së Kosovës, se raporti juaj me librin është magjia më vendimtare që e përcakton të ardhmen tuaj. Nëse ju mendoni se keni ndonjë dëshirë për ta realizuar, ju njoftoj se të gjitha gjërat më të bukura të jetës që dëshironi t'i arrini, qofshin ato në aspektin shpirtëror, kreativ, material, do t'i keni të mundshme përmes librit. Ju e dini se ne kemi probleme me arsimin tash e një kohë të gjatë. Por, ju garantoj një gjë, nëse ju ndërtoni një raport të mirëfilltë me leximin, do t'i tejkaloni të gjitha pengesat e mundshme", ka thënë Hoti në fjalimin e tij.

Fjalë urimi për koordinatorin



Hoti dhe për nxënësit fitues pati edhe drejtoresha Komunale e Arsimit, Xhemile Vezgishi. "Para

se të nisesha për të ardhur në këtë takim po mendoja për dhuratat që do t'i merrni. Nesër

do të mund të merrni edhe dhurata të tjera, por nuk e dinë do të kishte ndonjë dhuratë tjetër që do të kishte vlerë më shumë sesa librat që do t'i merrni sot. Imagjinoni sa me fat jeni që bibliotekave tuaja familjare sot do t'i shtohen edhe tituj e emra të mëdhenj të letërsisë botërore", ka thënë Vezgishi.

Komuna e Prizrenit ka pasur 3 241 nxënës fitues në të gjitha nivelet e garës nacionale në Kreativitet Kulturor e Mendim Kritik si dhe në Dituri. 32 në nivelin republikan, 164 në nivelin komunal dhe 3 045 fitues në nivelin shkollor të garës. Të gjithë këta nxënës janë shpërblyer nga KNKRS-ja me shpërblime si bursa, kampe kreative, certifikata dhe libra.

Fizika dhe kimia simetrike, udhëtim drejt universit (9)

Tornadot dhe ciklonet në brendësinë e protoneve, elektroneve dhe neutroneve



Shkruan: Naim KRASNIQI, fizikan

Prandaj, për ta zgjidhur problemin brenda strukturës së atomit, unë përmes zbulimit të fushës antimagnetike dhe antielektrostatike, duke u bazuar në disa fenomene që ndodhin në tokë, të cilat ende as që janë kuptuar, por për t'u dhënë një kuptim parimor shkaktarëve të ngarkesave të protonit dhe elektronit, e kam parë të pashmangshme inkuadrimit e dy fenomeneve ciklonin dhe tornadon, si bazë në strukturën e brendshme të atomit. Këto fenomene u japin një kuptim logjik dhe e jetësojnë funksionimin e mikrogrimcave që janë të ngjashme sikur për


| | Protonet | Elektronet | Neutronet |
|---------|---------------|---------------|-----------------|
| Cikloni | $(aX)p+(aY)p$ | $(aX)e+(aY)e$ | $(-aX)n+(-aY)n$ |
| Tornado | $(aX)p+(aZ)p$ | $(aX)e+(aZ)e$ | $(aX)n+(aY)n$ |

(aX). Prandaj, ashtu sikur është sqaruar edhe në botimet e "Epoka e re", 2019, në mes cikloneve të këtyre grimcave, qoftë te protoneve, neutroneve dhe elektroneve, veprojnë forcat e forta tërheqëse, përderisa fushat antielektrostatike janë forca që u kundërvihen forcave tërheqëse të këtyre grimcave. Por, për dallim thelbësor nga fenomenet e tornados dhe cikloneve te protonet dhe elektronet, ndryshe qëndron situata te neutronet. Sepse te këto mikrogrimca kemi një ndryshim të elementeve nga të cilat krijohen këto fenomene. a) Te neutroni tornadoja ka të njëjtin efekt $(aX)+(aZ)$ kurse në vend të ciklonit kemi anti-ciklonin $(-aX)+(-aY)$. Anticikloni shkakton valë shtytëse që shpërndahen nga qendra në drejtim të boshtit (x) dhe (y). Kurse sasia e elementeve $(-aX)$ dhe $(-aY)$ te neutronet është

njëkohësisht edhe forca shtytëse edhe tërheqëse. Shiko figurën 11. Forcat shtytëse veprojnë në mes ciklonit të protonit dhe anticiklonit të neutronit, kurse forcat tërheqëse në mes tornados së protonit dhe tornados së neutronit, si dhe forcë tërheqëse në mes ciklonit të protonit dhe tornados së neutronit. Në këtë mënyrë neutroni mbet në një distancë të caktuar nga protoni, e cila distancë varet nga nivelet energjetike, edhe pse në të ardhmen mund të ketë disa ndryshime. Shiko figurën 12. Tornadot dhe ciklonet kanë nivele të ndryshme energjetike, në brendësinë e protoneve (p+), elektroneve (e-) dhe neutroneve (n), si dhe ky nivel energjetik varet edhe nga sasia e elementeve (aX) , $(-aX)$, (aY) , $(-aY)$ dhe (aZ) . Tornadot dhe ciklonet i pose-

tura e brendshme. Kështu që në sistemin periodik të gjitha elementet kanë një numër të caktuar të elektroneve, protoneve dhe neutroneve. Prandaj ky numër i protoneve elektroneve dhe neutroneve varet pikërisht nga niveli energjetik i këtyre elementeve në brendësi të këtyre grimcave. Por niveli energjetik i (aX) , $(-aX)$, (aY) , $(-aY)$ dhe (aZ) , është tejet kompleks, sepse ky nivel energjetik mund të jetë stabil dhe labil. a. Niveli energjetik stabil: E quajmë nivel energjetik stabil nëse nuk vepron ndonjë faktor i jashtëm që e ndërron nivelin energjetik të tyre. b. Niveli energjetik labil: Ky nivel energjetik në një formë a tjetër, duke mos përjashtuar edhe faktorin njeri arrihet deri te ndërrimi përkatësisht rritja e nivelin energjetik të fenomeneve të lartë përmendura të protonet, elektronet dhe neutronet. Nëse ndryshon përkatësisht rritet niveli energjetik i tyre këto grimca elementare kalojnë në vetërigenerator të grimcave të ndryshme. Kjo mënyrë është vërtetuar eksperimentalisht kur polet e një magneti mbyllen me materiale feromagnetike kemi rritjen e fushës magnetike. Prandaj ajo rritje e fluksit të fushës magnetike nuk është asgjë tjetër pos vetërigjenerim i fushës magnetike. Prandaj varësisht nga niveli energjetik që e pranojnë fenomenet te protonet, elektronet dhe neutronet përmes një force të jashtme mund të kalojnë nga sistemi energjetik stabil në nivelin energjetik labil me ç'rast këto grimca kthehen në vetërigenerator të mikrogrimcave të ndryshme, kështu që: a) Protonet do të riprodho-


jnë mikrogrimca (?), b) Elektronet (e-) riprodhojnë mikrogrimca (?) dhe c) Neutronet (n) riprodhojnë mikrogrimca (?). Pavarësisht ndërrimit të nivelit energjetik të protoneve, neutroneve dhe elektroneve, edhe pse kthehen në vetërigjenartot ato mbesin prapë se prapë protone, elektrone dhe neutrone brenda strukturës së brendshme të ati materiali, duke përfshirë edhe materialet feromagnetike, por dalin mikrogrimcat e riprodhuara. Do të thotë se këto mikrogrimca pavarësisht nivelit energjetik nuk dalin jashtë materialeve feromagnetike qoftë nga hekuri, nikeli apo kobalti, dhe nuk lëvizin nga këto materiale, përkatësisht janë statike brenda materialeve prej nga krijohen fushat qoftë elektrike, magnetike apo elektromagnetike. Një forcë e jashtme e cila mund ta ndërroi përkatësisht ta rritë nivelin energjetik të cikloneve dhe tornados brenda protoneve, elektroneve dhe neutroneve është ashtu sikur e cekëm më lartë edhe faktori njeri, përmes përdorimit të fushave magnetike të krijuara nga rrymat elektrike. Prandaj për ta kuptuar më mirë se pse këto grimca elementare mund të kalojnë me vetëdije apo pa vetëdije në vetërigenerator, ne duhet të kthehemi te forma e magnetizimit të magnetëve qoftë permanent apo elektromagnetëve. Në këtë mënyrë për ta kuptuar më thjeshtë ne do të marrim si shembull si ndodhë ndërrimi i nivelit energjetik i protoneve, elektroneve dhe neutroneve brenda një materiali feromagnetik i cili vendoset në një fushë magnetike. (VIJON)



makrobotën ashtu edhe për mikrobotën. Në këtë mënyrë pjesë e strukturës së brendshme të protoneve, elektroneve dhe neutroneve, përpos kuarkeve statike të lartpërmendura, në brendinë e tyre janë të pranishme edhe cikloni dhe tornadoja si dy fenomene kryesore. Në këtë mënyrë pjesë e strukturës së brendshme të protoneve, elektroneve dhe neutroneve, përpos kuarkeve statike të lartpërmendura, në brendinë e tyre janë të pranishme edhe cikloni dhe tornadoja si dy fenomene kryesore. Bazuar në dy rastet e lartpërmendura, ku gjatë bashkëveprimit të atomeve të elementeve (aX) dhe (aY) formohen ciklonet, kurse për ndryshim nga ciklonet tornadot formohen gjatë bashkëveprimit të atomeve të elementeve (aX) dhe (aZ) , çka do të thotë se sikur ciklonet ashtu edhe tornadot kanë një element të përbashkët

tejet e vogël në krahasim me protonet dhe elektronet. Ky është edhe një prioritet që e mban stabil bërthamën e atomit. Kështu te neutroni kemi fenomenin e anticiklonit $(-aX)n+(-aY)n$ të një niveli energjetik shumë më të ulët se te dhe protoni. Rritja e nivelit energjetik te neutroni përmes një force të jashtme bërthamën e atomit e ndanë në dy pjesë të paktën. Një provokim i tillë është tejet i rrezikshëm nëse nuk kontrollonhet. b) Këto fenomene tani te këto grimca elementare e marrin këtë formë. Shiko tabelën. Pasi në mes protonit dhe elektronit vepron forca tërheqëse në mes cikloneve të këtyre grimcave, kurse kësaj force tërheqëse i kundërvihet fusha antielektrostatike, qoftë e elektronit ashtu edhe e protonit. Kurse te neutroni situata është ndryshe, pavarësisht nivelit të ulët energjetik të neutronit, prapëseprapë në mes të neutronit dhe protonit, veprojnë

don secili element i sistemit periodik, edhe pse nga shkenca këto elemente nuk njihen. Mos njohja e këtyre elementeve (aX) , $(-aX)$, (aY) , $(-aY)$ dhe (aZ) , i konsideron të gjitha elementet e sistemit periodik si të pandryshueshme për nga struk-



Ligjvënësit rusë u japin mbështetje reformave të Putinit

MOSKË, 23 JANAR - Ligjvënësit rusë miratuan në mënyrë unanime, në lexim të parë, Ligjin për reforma kushtetuese, të propozuar nga presidenti Vladimir Putin.

Të 432 ligjvënësit e pranishëm në Dumën Shtetërore votuan në favor të ligjit.

"Kjo është një shenjë e fuqishme e unitetit", tha kryetari i Dumës, Vyacheslav Volodin, pas votimit. Ai njoftoi se leximi i dytë pritet të mbahet më 11 shkurt.

Ligji do të kalojë edhe në lexim të tretë, por, meqë parlamenti

dominohet nga ligjvënës besnikë të Kremlinit, ai nuk ka gjasa të refuzohet.

Pasi të miratohet në Dumë, ligji kalon në Këshillin e Federatës dhe pastaj nënkshkohet nga Putini.

Njoftimi i Putinit për reforma, gjatë një fjalimi drejtuar kombit më 15 janar, është pasuar me dorëheqjen e shpejtë të qeverisë së Dmitry Medvedevit dhe emërimin e kryeministrit dhe kabinetit të ri.

Zhvillimet e shpejta kanë bërë që

vëzhguesit të thonë se Putini mund të jetë duke përgatitur terrenin për të mbajtur pushtetin edhe pas përfundimit të mandatit të tij aktual, më 2024.

Putin, 67 vjeç, ka dominuar politikën ruse për dy dekada, duke shërbyer herë si president, herë si kryeministër nga viti 1999.

Në vitin 2018, ai është rizgjedhur president për një mandat të ri 6-vjeçar.

Me ligjin aktual, ai do të duhet të tërhiqet pas përfundimit të mandatit.



Përvjetori i Holokaustit mbledh liderët botërorë



Jerusalemi mbledhi liderë shtete të ndryshme për të shënuar 75-vjetorin e çlirimit të kampit të përqendrimit të Aushvicit në Poloni, në ceremoninë që u mbajt në kohën kur sulmet kundër hebrenjve kanë shënuar rritje në Evropë dhe në mbarë botën

TEL AVIV, 23 JANAR - Krerët e shteteve dhe qeverive nga dhjetëra vende mbërritën në Jerusalem për të shënuar 75-vjetorin e çlirimit të kampit të përqendrimit të Aushvicit në Poloni.

Ceremonia përkujtimore në Jerusalem, u mbajt në kohën kur sulmet kundër hebrenjve kanë shënuar rritje në Evropë dhe në mbarë botën.

Në mesin e pjesëmarrësve ishin: presidenti rus Vladimir Putin, ai francez Emmanuel Macron, Princi i Britanisë së Madhe Charles, nënpresidenti i ShBA-së, Mike Pence si dhe presidentët e Gjermanisë, Italisë dhe

Austrisë.

Forumi Botëror i Holokaustit është tubimi më i madh në përkujtim të Holokaustit dhe luftimit të antisemitizmit në ditët moderne.

Sidoqoftë, presidenti polak, Andrzej Duda, nuk pranoi të marrë pjesë, në shenjë pakënaqësie që nuk iu lejua të marrë fjalën, ndërsa përfaqësuesit e Ruisë, Francës, Britanisë, Shteteve të Bashkuara dhe Gjermanisë mbajtën fjalime, ka njoftuar rfe.

Organizatorët izraelitë thanë se vetëm katër aleatët e Luftës së Dytë Botërore dhe Gjermania do të flasin në këtë ngjarje.

Më shumë se 1 milion njerëz, shumica e tyre hebrenj, u vranë në kampin e përqendrimit Aushvic-Birkenau gjatë okupimit të Polonisë nga Gjermania naziste.

Gjashtë milionë hebrenj u vranë gjatë Holokaustit.

Në një pritje që organizoi në prag të tubimit, presidenti i Izraelit, Reuven Rivlin, u bëri thirrje udhëheqësve botërorë që të lënë historinë për historianët. "Roli i liderëve politikë është të formësojmë të ardhmen", tha Rivlin.

"Shpresoj dhe lutem që udhëheqësit e botës do të qëndrojnë të bashkuar në luftën kundër

racizmit, antisemitizmit dhe ekstremizmit, në mbrojtjen e demokracisë dhe vlerave demokratike. Kjo është sfida jonë. Kjo është zgjedhja jonë", tha ai.

Para forumit, deklaratat e liderëve botërorë flisnin për një angazhim të shtuar në shuarjen e një klime, për të cilën disa thanë se sjellë në kujtesë atë të para Luftës së Dytë Botërore.

"Unë theksoj shpresën time të zjarrtë, që me vigjencë të vazhdueshme dhe edukim pozitiv, ligësitë e kryera gjatë periudhave më të errëta në historinë tonë do të eliminohen nga faqja e dheut", shkroi Papa Françesku.

Presidenti francez, Emmanuel Macron, dënoi antisemitizmin në nivel global.

"Këtë luftë kundër antisemitizmit, unë e udhëheq çdo ditë duke e trajtuar atë në fjalime, në

sjellje, në internet", tha Macroni.

Kryeministri kanadez, Justin Trudeau, përmendi në mënyrë të veçantë plagën e antisemitizmit dhe urrëjtjes, e cila edhe një herë po bëhet shumë e zakonshme.

"Vrasja e gjashtë milionë hebrenjve nga regjimi brutal dhe antisemitik nazist filloi me një erozion të ngadaltë të të drejtave dhe normalizimit e diskriminimit. Ne nuk mund të lejojmë që kalimi i kohës të zvogëlojë vendosmërinë tonë për të mos lejuar që tmerre të tilla të ndodhin përsëri", shkroi ai.

Ngjarja shënon një nga tubimet më të mëdha politike në historinë e Izraelit.

Më shumë se 10,000 oficerë policie u vendosën në Jerusalem, ndërsa autostradat kryesore dhe pjesë të mëdha të qytetit ishin mbyllur përpara fillimit të ceremonisë.

Koreja Veriore për herë të parë në Konferencën për Sigurinë

BERLIN, 23 JANAR - Koreja e Veriut do të marrë për herë të parë një ftesë për në Konferencën e Mynihut për Sigurinë, që zhvillohet në

shkurt, sipas organizatorëve. Sipas një zëdhënësi, Pheniani do të dërgojë atje zëvendësministrin e Jashtëm, Kim Son Gyong.

Të martën, në Davos, Pheniani paralajmëroi se mund të kërkojë një rrugë të re për t'i mbrojtur interesat e tij dhe për të përshpejtuar pro-

gramin e tij të armëve, pas sanksioneve të reja amerikane, ndërkohë që negociatat mes dy shteteve janë futur në një rrugë pa krye.



SIGMA

VIENNA INSURANCE GROUP

SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A. DEGA KOSOVË

NJOFTIM PËR ZHVENDOSJE TË ZYRËS

Të nderuar klientë dhe palë të interesuara,
Ju njoftojmë se Zyra Qendrore e kompanisë së sigurimeve Sigma Inter Albanian Vienna Insurance Group Sh.A. Dega Kosovë do të zhvendoset në adresën e re, që është:

• Aktash, Rr. Edmond Hoxha nr. 27 (afër udhëkryqit tek menza e studentëve), Prishtinë 10000, Republika e Kosovës

Data e planifikuar/propozuar dhe për zhvendosjen e zyrës qendrore është 23.12.2019.

Ne do të vazhdojmë të jemi në dispozicionin tuaj për t'ju ofruar shërbimet e kompanisë tonë të sigurimeve në adresën e re të lartshënuar të Zyrës Qendrore.

Ju faleminderit për mirëkuptimin dhe ju mirëpresim në zyrat e reja!

NOTICE FOR OFFICE TRANSFER

Dear clients and interested parties,
We inform you that the Head Office of insurance company Sigma Inter Albanian Vienna Insurance Group Sh.A. Kosovo Branch will move to the new address, that is:

• Aktash, Edmond Hoxha Str. No. 27 (near the crossroads of the student mess canteen), Prishtina 10000, Republic of Kosova

The planned/proposed date for the Head Office transfer is 23.12.2019.

We will continue to be at your disposal to offer our insurance company's services at the above new Head Office address.

Thank you for your understanding and welcome to the new offices!

OBAVIJEST O ZAMJENI KANCELARIJE

Dragi klijenti i zainteresovane strane,
Obaveštavamo vas da će glavno sedište osiguravajućeg društva Sigma Inter Albanian Vienna Insurance Group Sh.A. Filijala Kosova preseliti na novu adresu, a to je:

• Aktash, Ul. Edmond Hoxha br. 27 (blizu raskrsnice studentske menze), Priština 10000, Republika Kosova

Planirani/predložni datum preseljenja kancelarije na novu adresu glavnog sedišta je 23.12.2019.

Me čemo i dalje biti na vašem raspolaganju da vam pružimo usluge našeg osiguravajućeg društva na gore navedenu novu adresu glavne kancelarije.

Hvala vam na razumevanju i dobrodošli u nove kancelarije!



SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A. - DEGA KOSOVË

Qyteza Pejton, Rr. Ukshin Hoti Nr.13, Prishtinë, Republika e Kosovës

Tel.+381 38 246 301, Fax. +381 38 246 302 www.sigma-ks.net info@sigma-ks.net

Kur një shoqëri fillon të ketë frikë nga poetët e vet, kjo do të thotë se ka frikë nga vetja



Nga: Lenore KANDEL
Përktheu: Leonora BUÇINCA

Poezia nuk komprometohet kurrë. Është manifestimi – përthim i një vizioni, një ndriçim, një përvojë. Nëse bëni kompromis, bëheni një profet i verbër.

Nuk ka kuptim sot në atë poezi që ekziston vetëm si një detyrë e ushtrimit. Teknika është e nevojshme për aq kohë sa shërben si një mami e aftë për qartësi, bukuri, vizion.

Kur dashurohet me veten, ajo prodhon masturbim verbal. Poezitë që unë shkruaj kanë të bëjnë me të gjitha aspektet e krijesës dhe të atij universi total përmes të cilit lëviz. Qëllimi është të rritet ndërgjegjësia. Kjo mund të jetë vetëdije për mënyrën se si një zog shpërthen qiellin me fluturimin e tij ose vetëdijen për vështirësinë dhe nevojën për besim ose vetëdije për dëshirën për vetëdijen, madje edhe për frikën e vetëdijes. Dhe, kjo mund të arrihet përmes bukurisë ose tronditjes ose të qeshurës, por drejtimi është gjithnjë drejt një pamje të qartë, të brendshme dhe të jashtme.

Kjo kërkon ndershmëri brenda poetit dhe poezisë. Një i sinqertë, nganjëherë i gëzuar, ndonjëherë i dhimbshëm, drejtuar vetë poetit ose lexuesit ose të dyve. Dy nga poezitë e mia, të botuara në një

libër të vogël, kanë të bëjnë me dashurinë fizike dhe thirrjen, njohjen dhe pranimin e hyjnisë të njeriu përmes mediumit të dashurisë fizike. Me fjalë të tjera, është kënaqësi. Një kënaqësi kaq e madhe sa ju bën të aftë të dilni nga vetja juaj private dhe të merrni pjesë në hirin e universit. Ky formulim i thjeshtë dhe mjaft i dukshëm, i zgjeruar dhe i ilustruar poetikisht, ka ngritur një tërbim të vështirë për t'u besuar. Pjesa më e madhe e këtij tërbimi ishte për shkak të përdorimit poetik të fjalëve të caktuara të katër shkronjave me origjinë anglo-saksone, të cilat nuk u zëvendësuan me gufemizma më delikate.

Nga këtu arrijmë te pyetja e gjuhës poetike.

E gjithë ajo që është gjuhë, është gjuhë poetike dhe nëse fjala e kërkuar nga poeti nuk ekziston në gjuhën e njohur për të, atëherë i takon atij ta zbulojë. Kushti i vetëm kufizues mund të jetë që fjala është e sakta që kërkohet nga poezia dhe vetëm poeti mund të jetë gjykatësi i fundit i saj. Eufemizmat e zgjedhur nga frika janë një pakt me hipokrizinë dhe në afatin e menjëhershëm ata do ta shkatërrojnë poezinë dhe përfundimisht dhe do ta shkatërrojnë poetin.

Çdo formë e censurës, mendore, morale, emocionale ose fizike, qoftë nga brenda apo nga jashtë, është një pengesë kundër vetëdijes. Poezia është e gjallë sepse

është një medium vizioni dhe përvojë. Nuk është domosdoshmërisht e këndshme. Nuk është domosdoshmërisht e padëmshme.

Poezia doli nga një klasë e shkollës, pastaj shkoj në rrugë dhe kështu prodhoi një rrjedhë të palmave të kryqëzuara, të cilat dhanë shumë fruta jetike si për poezinë ashtu edhe për shkollën. Bota akademike donte të gjeneronte frikën në shkëlqen e kodit, duke ofenduar dikë. Vizionet dhe gjuha shpesh bëheshin më të vogla, të mbytura nga një shurdhëri. Një poezi pastaj bëhej shpeshherë mjet për gjimnastikën letrare.

Poezia e rrugës shmang kurthin e frikës, por shumë shpesh ajo humb vizionet e veta për mungesë qartësie, për ngurtësi, për mungesë arti si profesion. Poezia që është poezi nuk ka nevojë të klasifikohet sipas dy kutive të përshkruara më lart e as në ndonjë mënyrë tjetër. Nuk mund të ekzistojë në shoqërinë e censurës. Nëse një poet censuron vizionin e tij ai nuk thotë më të vërtetën kur e sheh atë. Nëse censuron gjuhën në një poezi, ai nuk përdor ato fjalë që për të janë fjalët më të përsosura që ai duhet t'i përdorë. Ky vetëplanifikim krijon një kufizim artificial të imponuar ndaj një arti, drejtimi i të cilit është përtej kufijve të mundshëm. Nuk ka pengesa për poezinë apo profecinë. Për nga natyra e tyre ato shkelin çdo pengesë, ato janë qël-

lime perceptimi, linja drejt pafundësisë. Nëse një poet gënjën mbi vizionin e tij, ai gënjën mbi veten dhe për veten e tij dhe kjo prodhon një pengesë të vërtetë. Kur një poet, për oportunitizëm, diktuar nga frika, përdor një gjuhë të ndryshme nga ajo që është e përsosur për një poezi, ai bëhet person me oportunitizëm të frikshëm. Kur një agent i jashtëm merr përsipër detyrën e censurimit të poezisë, kjo nënkupton censurimin e pranimit të së vërtetës dhe kërcimin drejt zbulimit.

Kur një shoqëri fillon të ketë frikë nga poetët e vet, kjo do të thotë se ka frikë nga vetvetja është një mënyrë tjetër për ta përcaktuar ferrin. Një poezi pasi është shkruar dhe botuar është në dispozicion për ata që vendosin ta lexojnë atë. Sipas mendimit tim, kjo nënkupton një përgjegjësi të thellë nga ana e poetit, i cili thotë të vërtetën ashtu siç ai e sheh. Lëreni ta thotë me gjithë bukurinë, aftësinë për të befasuar, për të cilën është i zoti; të shkaktojë ndjenjën e tij për çudi; të përdorë alkimi brenda gjuhës – këto janë forma dhe ekzistenca e vet poezisë. Publiku i poezisë moderne është kryesisht i ri. Të lëvizim në një botë ku polaritetet dhe mundësitë e jetës dhe vdekjes ekzistojnë si një prani e vazhdueshme e vetëdijes. Pasi koncepti dhe fizibiliteti i mbin-

garkesës, madje edhe i potencialit të tepërt shkatërrues, është bërë i njohur për të gjithë, aura e mundësisë së një vdekjeje kozmike është bërë e dukshme. Ishin epokat kur të rinjtë mund të rrëshqitnin butësisht në jetën e tyre si pleq e, nëse donin t'i injoronin problemet më të thella të njerëzimit, të marrëdhënies së njeriut me njeriun, kjo u lehtësohej atyre. Epoka jonë sigurisht që nuk është një nga ato dhe zgjedhjet e të rinjve janë të thella dhe të vështira. Nën tetëmbëdhjetë vjeç djemtë duhet të vendosin nëse do t'i përkushtohen kalimit kombëtar të vdekjes. Shumë nga ata, në vend se ta pranojnë botën e luftës dhe dëshpërimin personal që u propozohet atyre nga shumica e të pjekurve, zgjedhin të manifestojnë një mënyrë të ndryshme të jetës, të motivuar drejt kënaqësisë, drejt ndriçimit dhe vëmendjes së ndërsjellë.

Këto janë zgjedhje të vështira për t'u bërë, të cilat nuk lejojnë ikje. Ata që lexojnë poezinë moderne e bëjnë për kënaqësi, për ta njohur më thellë, ndonjëherë edhe për të gjetur këshilla. Dhe më së paku që mund të presin është se poeti që ndan vizionet dhe përvojat e tij me ta, e bën këtë pa hipokrizi. Bërja e kompromiseve në poezi nga frika nënkupton atrofizimin e psikikës. Kompromisi për oportunitizëm në poezi është kapësja* e vogël vrasëse e shpirtit.

/Revista "Akademia"/

A ka ekzistuar Lufta e Trojës?

Nga: Daisy DUNN/BBC

Duke përgatitur librin e ri me tregime antike – të përkthyer nga shkrimtarët e mëdhenj, “Për zotët dhe njeriun” – u çudita kur zbulova sesa i përhapur ndër shekuj ka qenë tregimi për Luftën e Trojës. Autorët e ndryshëm, si John Dryden, Alexander Pope dhe Louis MacNeice, janë nxitur të përkthejnë versione të ndryshme të mitit klasik. Një arsye se pse Lufta e Trojës ka prekur telat e njerëzve – pos që është një histori e shkëlqyeshme – është fakti se prej kohësh dyshohet nëse ajo ka ndodhur me të vërtetë.

Për shumicën e grekëve të lashtë, Lufta e Trojës në fakt ishte më shumë sesa një mit. Ishte një moment që përcaktonte epokën e të kaluarës së tyre. Siç tregojnë burimet historike – nga Herodoti dhe Eratosteni – përgjithësisht supozohej se ajo ka qenë një ngjarje e vërtetë.

Sipas “Iliadës” së Homerit, konflikti midis grekëve – të udhëhequr nga Agamemnoni, Mbreti i Mikenës – dhe trojanëve – mbreti i të cilit ishte Priami – u zhvillua në Epokën e Bronzit të Vonë dhe zgjati 10 vjet. Filloi kur Parisi, djali i pafat i Priamit, e gjykoj Afërditën të jetë perëndesha më e bukur, për çka si kompensim ia dha për dhuratë balldëskën e mrekulueshme të Agamemnonit, Helenën. I përcaktuar për ta rikthyer Helenën dhe për të ndëshkuar trojanët, Agamemnoni dhe vëllai i tij

marshuan me një ushtri të fuqishme kundër Trojës, dhe përfundimisht arritën të gjunjëzojnë njerëzit e saj.

Në Antikitë, madje edhe historianët e respektuar ishin të gatshëm të besojnë se kjo luftë me të vërtetë ka ndodhur. Në gjysmën e dytë të shekullit të V-të, Herodoti – i ashtuquajtur “Babai i Historisë” – e vendosi Luftën e Trojës pothuajse 800 vjet para kohës së tij. Matematikani Eratosteni ishte më specifik, duke e datuar luftën në vitet 1184 ose 1183 p.e.s. Studiuesit modernë, megjithatë, kanë prirje të jenë më skeptikë.

Ndaj, a ndodhi Lufta e Trojës?

Dilema është në epiqendër të “Trojës: Miti dhe Realiteti” – ekspozitë kjo e hapur në Muzeun Britanik të Londrës. Vazot greke, afresket romake dhe shumë vepra të artit bashkëkohor që përshkruajnë historitë e frymëzuara nga Troja, janë ekspozuar krahas artefakteve arkeologjike që datojnë nga Epoka e Bronzit të Vonë. Ajo që del qartë nga ekspozita është sesa shumë njerëz të etur ka pasur gjatë historisë, për të gjetur disa të vërteta në rrëfimin për Luftën e Trojës. Romakët shkuan aq larg sa ta paraqesin veten si pasardhës të trojanëve të mbijetuar. Në poemën e tij “Eneida”, Virgili shkruan sesi heroi Eneu shpëtoi nga kështjella e djegur me një grup ndjekësish, pasi grekët hynë me kalin e tyre prej druri.

John Dryden, Poeti i parë Laureat i Anglisë, e përktheu në mënyrë të shkëlqyeshme pjesën kur u bë kali: “Grekët u lodhen nga lufta e mërzhitshme/ dhe, me ndihmën e Minervës, një strukturë ndërtuan/ që u shfaq si një kalë me lartësi monstruoze”. Eneu dhe burrat e tij u nisën për të gjetur një shtëpi të re në Itali.

Nuk është për t’u habitur sesi njerëzit kanë qenë të bindur për realitetin e Luftës së Trojës. Realitetet e pamëshirshme të betejës janë përshkruar me aq përkushtim në “Iliadë” sa që është vështirë të besohet se ato nuk bazoheshin në vëzhgime. Një ushtar vdes nga uji dhe “ngjallat e peshqit u sollën rreth tij, duke u ushqyer dhe gllabëruar dhjamine përreth veshkave të tij”. Akili shpon me shtizë Hektorin, “në gurmaz, aty ku jeta e një njeriu shkatërrohet më shpejt”, siç e përktheu Martin Hammond. Edhe Troja, po ashtu, është portretizuar me ngjyra aq gjalla në epikë sa që një lexues nuk mund të rezistojë pos të transportohet në muret e saj madhështore.

Në fakt, ishte perspektiva e rizbulimit të Trojës së Homerit ajo që e shtyu biznesmenin e pasur prusian, Heinrich Schliemann, të udhëtonte në shekullin XIX në atë që sot është Turqi. Duke i thënë për një vendndodhje të mundshme të qytetit në Hisarlik, në bregun perëndimor të Turqisë moderne, ai nisi të gërmojë dhe të zbulojë një numër të madh të thesareve antike, shumë prej të cilave tani janë shfaqur në Muzeun

Britanik. Edhe pse fillimisht ia atribuoi shumë gjetje Epokës së Bronzit të Vonë – periudha në të cilën Homeri e vendosi Luftën e Trojës – e pasi ato në fakt ishin shekuj më të vjetra, ai e kishte gërmuar vendndodhjen e saktë. Shumica e historianëve tani pajtohen se Troja e lashtë gjendet në Hisarlik. Troja ishte e vërtetë.

Dëshmitë për zjarrin dhe zbulimi i një numri të vogël shigjetash në shtresën arkeologjike të Hisarlikut, që korrespondojnë me datën e periudhës së Luftës së Trojës të Homerit, mund të lënë të merret parasysh edhe lufta. Gjithashtu, mbijetojnë shkrimet e bëra nga hititët, nga popull i lashtë i vendosur në Turqinë e tashme qendrore, që e përshkruajnë një mosmarëveshje për Trojën të cilën ata e njihnin si “Vilusa”. Megjithatë, asnjë nga këto nuk paraqesin dëshmi për Luftën e Trojës. Por, për ata që besojnë se ka pasur konflikt, këto të dhëna janë të mirëseardhura.

Një Luftë historike e Trojës do të kishte qenë krejt ndryshe nga ajo që mbizotëron në epikën e Homerit. Është e vështirë të imagjinohet një luftë që zhvillohet në nivelin të cilën e përshkruan poeti, dhe që zgjat ashtu për 10 vjet (kur kështjella ishte mjaft kompakte, siç e kanë zbuluar arkeologët). Sjellja e ushtarëve në luftën e Homerit, megjithatë është shumë njerëzore dhe reale. Ndaj, gjenialiteti i Homerit ishte ta ngrinte konfliktin universal në diçka më të thellë, në mënyrë që të nxirrte në pah realitetet e luftës. Nuk do të

kishte zotëra që të ndikonin në rrjedhën e veprimit në një fushë-beteje të Epokës së Bronzit, por burrat që e panë veten të pushtuar nga një grindje e përgjakur, do të mund ta imagjinonin se ata ishin aty kur batica u kthye kundër tyre. Homeri kapi të vërtetat e përjetshme në momentet më fantastike të poemës.

Grekët e panë trashëgiminë e Luftës së Trojës si shpjegim për botën e përgjakshme dhe inferiore në të cilën jetuan. Akili dhe Odiseja kishin jetuar në një epokë heronjsh. Koha e tyre tashmë ka përdënuar, duke lënë pas tërë atë etjen për gjak, por asnjë nga heroizmat apo përsosmëritë luftarake të Luftës së Trojës. Edhe ngjarjet e pasluftës ishin plot me dhunë. Në një shfaqje të frymëzuar nga Homeri, e të përkthyer nga Louis MacNeice, tragjiku grek Eskili e përshkroi pasluftën ku Klitemnestra vret burrin e saj, Agamemnonin, “i cili, pa shpirt, sikur të ishte koka e një deleje/ sikur të nxirrej nga një kope e madhe/ e sakrifikoi vajzën e tij”, Ifigjeninë, për të kënaqur një perëndeshë në mënyrë që të mund të kishte erë të mirë për udhëtimin e tij për në Trojë.

Pa marrë parasysh sesa ndërlihdet me faktin, miti i Luftës së Trojës pati ndikim të madh tek grekët e lashtë dhe tek ne; pavarësisht nëse ishte frymëzuar nga një luftë e zhvilluar shumë kohë më parë, apo ishte thjesht një shpikje e zgjuar, ajo la gjurmë në botë dhe mbetet e tillë – me rëndësi monumentale historike.

/Përktheu: Telegrafi.com/




Harold Bloom: Si dhe përse të lexojmë

Leximi nuk duhet reshtur kurrë, sepse ai ka rëndësi të dorës së parë, për ta mbajtur sadopak gjallë aftësinë e formimit të gjykimit dhe mendimeve vetjake. Mënyra se si lexohet, mirë a keq, nuk mund varet vetëm prej nesh, porse arsyeja përse lexohet duhet me qenë vetëm e vetëm në shërbim të interesit tonë. Mund të lexohet thjesht për të vlarë kohën, sikurse mund të lexohet i yshtur prej një nevoje të thellë të brendshme, në një rast të këtillë, ka për të mbërritë më së mbrami ai çasti i pangjishëm kur leximi do të ta bëj natën ditë. Lexonjësit e Biblës, ata që përpiqen me gjetë biblën e vetvetes, ndoshta e trupëzojnë këtë nevojë të brendshme shumë më mirë se lexuesit e Shekspir, porse në të dyja rastet, prapëseprap, grishja është po ajo. Një nga shërbimet e të lexuarit, është të na përgatisë për ndryshimin tonë, dhe ndryshimi më i fundmë, ajme, është universal.

Mua leximi më shëmbëllen me një ritual vetmitar, më shumë se me një mision edukues. Mënyra se si lexojmë sot, kur jemi vetëm me veten tonë, përbën deri diku një vazhdimësi të leximit në të shkuarën, sidoqë sot leximi interpretohet nëpër akademi. Lexuesi im ideal (sikurse heroi im i përjetshëm) është Dr. Samuel Johnson-i, i cili ishte i vetëdijshëm për të dyja, fuqinë dhe pamundësinë e të lexuarit pareshtur. Sikurse çdo aktivitet tjetër i mendjes, ai duhet të përmbush parimin e parë të Johnson-it, leximin e asaj "çka na përshtatet më së miri, çka na sjell dobi." Sër Francis Bacon, përhapësi i disa prej ideve që Johnson-i vuri në jetë, pat dhënë një këshillë shumë të vyer "Lexo duke ruajtur gjykimin, pa t'u bërë trutë dhallë, duke mos besuar gjithçka mendjen pa e vlarë, jo për të rrahur ujë në havan me fjalë që s'kanë mbarim, por duke i dhënë peshë mendimit, duke u thelluar në gjykim." Unë do të vija përkrah Bacon-it dhe Johnsonit, një tjetër mendimtar të urtë, Emersonin, të ashprin armik të historisë dhe historicizmeve të çdo lloji, i cili pat theksuar se librat më të mirë "na trondisin me bindjen e thellë, se ajo nevojë e brendshme që shkruan, po ajo lexon."

Lejomëni atëherë të bëj njësh thëniet e Bacon-it, Johnson-it, edhe Emerson-it, për të përfutur një formulë të vetme se si të lexojmë: lexo çka më së miri të përshtatet, çka të sjell dobi, libra që i japin peshë mendimit duke të thelluar në gjykim, libra që të trondisin ngase keni të njëjtën natyrë, të pacënuar nga e tirani e kohës. Pikë për pikë, kjo do të thotë, në fillim gjejeni ju Shekspirin, mandej lëreni t'ju



gjej. Nëse leximi i Mbreti Lir, ju rrëmben të tërin, atëherë mendoni e gjykoni për natyrën e njëjtë që personazhi ndan me ju; afrinë me veten tënde. Vetëmse këtë s'e shoh asfare si idealizëm por si pragmatizëm. Ta gjykosh këtë tragjedi si akuzë kundër sistemit patriarkal do të thotë të heqësh dorë nga interesat e tua më vetjake, sidomos kur kemi të bëjmë me lexuese, çka është më ironike se sa duket. Shakespeare, më shumë se sa Sophocles, përbën një autoritet të padiskutueshëm dhe të pashmangshëm për sa i përket konfliktit ndërmjet brezave, dhe më shumë se kushdo tjetër, në lidhje me ndryshimet ndërmjet grave dhe burrave. Jini të hapur kundrejt një leximi të shumëanshëm të Mbreti Lir, dhe kësaj do të kuptoni shumë më mirë origjinën e asaj çka ju e quani patriarkat.

Në fund të fundit - ne lexojmë - sikurse Bacon-i, Johnson-i, dhe Emerson-i do të ishin të një mendjeje - për të forcuar unin tonë, për të mësuar interesat e tij të qenësishme. Leximi na trand së brendshmi duke na dhënë ndiesi të atilla kënaqësi të cilat shpëgojnë deri diku se përse vlerat estetike janë nënvlerësuar nga moralistët socialë, qysh prej Platonit deri tek kampi i sotshëm i puritanëve. Kënaqësitë leximore janë në të vërtetë egoiste më shumë se sociale. Nuk është se përmirësohet drejtpërdrejt jeta e ndokujt nëse leximi është më i mirë e më i thellë. Mbetem mosbesues ndaj shpresës tradicionale sociale se kujdesi ndaj të tjerëve mund të nxitet prej gjallërimit të imagjinatës vetjake, sikurse jam i tejnginjur me argumentat e gjertanishme që përfaqasin ëndjet e leximit vetmitar me të mirën publike.

Ajo çka është e trishtueshme sa i përket leximit në mënyrë profesionale është fakti se rrallë ndodh të ndiesh sërish atë mrekullim të dikurshëm që të ngjallte leximi

në rini, atëkohë kur librat mbartnin "mrekullimin hazlitian". Mënyra se si lexojmë sot, varet deri diku apo plotësisht nga largësia, qoftë kjo e brendshme apo e jashtme, që ne vendosim në lidhje me universitetet, vendet ku leximi rrallë mësohet si kënaqësi, në kuptimin më të thellë të estetikës së kënaqësisë. Hapja e vetvetes kundrejt një përballjeje të drejtpërdrejtë me Shekspirin në kulmin e fuqisë së tij krijuese, sikurse është Mbreti Lir, asnjëherë nuk është e lehtë, në të ri sikurse në pleqëri, dhe prapëseprapë të mos e lexosh në plotinë e vet Mbreti Lir (çka do të thotë pa kurrfarë manteli ideologjik) do të thotë të mashtrosh botërisht vetveten edhe në gjykim edhe estetikisht. Një femijeri ku pjesën më të madhe të kohës e zë televizori domosdo shpie tek një adoleshencë ku kohën e gllabëron kompjuteri, dhe kësajsoj në dyert e univesitetit kemi një student që s'ka gjasa ta mirëpresë idenë se nevojitet durim në këtë rrugëtim që s'njeh fund deri në cakun e mbramë: urtinë që është gjithçka. Shmangia e këtij rrugëtimi e bjerr aftësinë e leximit, sikurse vetë unin bashkë me të. Keqardhja në këso rastesh s'ka kurrfarë vlere ashtu si zotimet e programet e paskëtajshme të leximit. Gjithçka ende mund të ndryshohet, mund të bëhet prej një lloji elite, gjë në fakt është e papranueshme, për shumë arsye, të mira e të këqija bashkë. Kjo ngase edhe sot ka akoma lexues vetmitarë, të rinj e të vjetër, kudo, madje edhe në universitete. Nëse kritika shërbën për ndofarë gjëje ende në kohën tonë, shërbën sepse i drejtohet këtij lexuesi, lexuesi që lexon për vetveten, dhe jo për interesa që me gjasë e tejkalojnë vetveten.

Vlera në letërsi sikurse në jetë, më së shumti ka të bëjë me të veçantën fshehatare, atë që kalon cakun e të zakonshmes, të tepërtën prej së cilës merr jetë

kuptimi. Nuk është rastësi që historiografët - kritikët që besojnë se njerëzit janë produkt i historisë shoqërore - i shohin personazhet letrarë thjesht si gjurmë të lëna në letër, dhe kaq. Hamleti as që përbën një të vërtetë historike nëse mendimet që kemi nuk na përkasin ne. Kjo na sjell tek parimi i parë, që mund të përmirësojë mënyrën se si lexojmë sot, parim që ja detyroj Dr. Johnson-it: "Çliroje mendjen prej klisheve" Fjalori të dëftën që klisheja është ligjërim i stërfyryrë me banalitete të rëndomta, fjalor i stërcudtitshëm si ai i një sektit a kultit shtriganësh.

Meqënesa universitetet kanë fuqizuar kulte të tilla si "gjinia dhe seksualiteti" dhe "multikulturalizmi," qortimi i Johnson-it kësajsoj shndërrohet në "çliroje mendjen nga kilshetë akademike." Një kulturë universitare që vlerëson më shumë të brendshmet e femrave të periudhës viktoriane se sa vlerëson Çarls Dikensin dhe Robert Browning-un i ngjan një dalldie si ato që përshkruan Nathaniel West-i, gjë që tashmë është kthyer në as më shumë dhe as më pak se në standart. Produkt anësor i një "kulture poetike" të këtillë është fakti se nuk arrin të nxjerrë as edhe një Nathaniel West, dhe as nuk e degdis qoftë edhe ky fakt një kulturë akdemikë të allasojtë në zgripin e paradisë? Poemat e një mjedisi të kësoshëm akademik janë zëvendësuar nga të brendshmet e kulturës sonë. Materialistët tanë riosh na dëftojnë se i kanë kthyer trupin historiografisë, dhe shpallin se punojnë në emër të Parimit të Realitetit. Jeta e mendjes duhet të mposhtë vdekjen e trupit, por prapëseprapë kjo as që ka nevojë për bujën zulmëmadhe të një sektit akademik.

Parimi i çlirimit të mendjes prej klisheve na shpie tek parimi i dytë i ringjalljes së leximit: Mos u orvat të bësh më të mirë fqinj apo lagjen me atë që lexon apo si

e lexon. Vetëpërmirësimi është një projekt aq madhor sa të mjafton vetja, mendja dhe shpirti yt: për to s'ka kurrfarë etike leximi. Mendja duhet mbajtur e përqendruar në shtëpinë tënde derisa padituria e saj e mirëfilltë të jetë zbur me gjithsej; angazhimi i parakohshëm është magjepsës në vetvete, por merr shumë kohë, kohë e cila për leximin nuk do të jetë e mjaftueshme kurrë. Shkrimi për historinë, qoftë ajo e tashme apo e shkuar, është një lloj idhujtarie, adhurim i vazhdueshëm për çka ndodh në kohë. Lexo atëherë i udhëhequr prej dritës së brendshme që kremtonte Xhon Miltoni dhe që Emersoni e kishte parim të leximit, parim që fare mire mund të jeti parimi ynë i tretë: Studiuesi është një qiri që ndizet gjithmonë prej dashurisë dhe gjakimeve të njerëzimit. Wallace Stevens-i, ndoshta duke e harruar autorin e tij, krijoi variante të mahnitshme të kësaj metafore, por fjalët burimore Emersoniane përbën një shprehje më të qartë të parimit të tretë të leximit. Nuk ka vend për drojen se liria e përmirësimit tënd si lexues përbën egoizëm, sepse nëse arrin të bëhesh lexues i mirëfilltë, atëherë fryti i mendimeve të tua do të shndërroj në një mendjendriçues për të tjerët.

U jam rikthyer shumë herë letrave që kam marrë prej njerëzish të panjohur tetë a nëntë vitet e fundit, dhe më ka ndodhur shpesh të prekem aq shumë prej tyre sa të mos mundem t'u kthej përgjigje. Pathosi që i përshkon, për mendimin tim, përbën më së shumti një nevojë të thellë për studimin letrar profesionist, detyrim që universitet nuk begenisin ta përmbushin. Emersoni ka shkruar se shoqëria nuk bën dot pa njerëz të kultivuar dhe shtoi në mënyrë profetike se: "vatra e shkrimtarit nuk është shkolla, por njerëzimi." Ai e kishte fjalën për shkrimtarë të fuqishëm, burra dhe gra që merrnin përsipër të ishin përfaqësues, përfaqësues të vetvetes, dhe jo kushtetutave, me të vetmen politikë atë që buron prej shpirtit njerëzor.

Funksioni më i lënë pas dore i edukimit universitar është nyjetuar përjetësisht në thirrjen e Emersonit drejtuar "Studiuesit amerikan", ku ai shpall se detyrat e studiuesit: "Mund të përmblihen të gjitha tek vetëbesimi." Unë marr nga Emersoni edhe parimin e katërt të leximit: Që te lexosh mirë duhet të kesh shpirt krijues. "Leximin krijues" në kuptimin Emersonian e kam quajtur një herë "keqlexim," fjalë që i bindi kundërshtarët e mi se vuaja nga disleksia kronike. Humbëtitra apo zbrazëti që ata shohin pas

leximit të një poeme është pasojë e mospasjes së një shpirti të tillë krijues. Vetëbesimi nuk është dhunti, por Rilindja e Dytë e mendjes, e cila nuk mund të ndodhë pa vite të tëra leximi të pareshtur. Estetika nuk ka standarde absolute. Nëse ndokush mëton se fuqia shekspiriane është produkt i kolonializmit atëherë kush po e vriska mendjen të argumentoj të kundërtën? Pas katër shekujsh Shekspiri është më i fuqishëm se kurrë; dramati i tij do të luhen në hapësira jashtëtokësore, në të tjera botë, nëse këto botë do të arrihen. Ai nuk përbën përjetim për kulturën Perëndimore; por mishëron të gjitha parimet e leximit dhe është pika ime e referimit në këtë libër. Borgesi ia mvishte këtë universalizëm mungesës së mirëfilltë të egoizmit të tij, cilësi që përbën një metaforë të shumëfishtë për dallimin mes Shakespear-it dhe të tjerëve, metaforë e fuqisë së tij njohëse si e tillë. Ne lexojmë, më shpesh e më shumë se sa ne mendojmë se lexojmë, në kërkim të një mendjeje më origjinale se e jona.

Ideologjia, sidomos në variantet me të cekëta të saj, është rrënuese sa i përket aftësisë së të kuptuarit dhe vlerësimit të ironisë, ngase unë sugjeroj që ringjallja e ironisë të jetë parimi ynë i pestë i ripërtëritjes së leximit. Mendoni ironinë e pafundme të Hamlet-it, i cili kur thotë diçka nënkupton kryekrejt diçka tjetër, më së shumti krejt të kundërt me atë që thotë. Por, ky parim, sikur ma vret shpirtin, prejse s'ka gjasa t'i mësoh dikujt të jetë ironik sikurse të bëhet lexues vetmitar. Prapëseprapë, humbja e ironisë shënon vdekjen e leximit, të asaj çka përbën qytetërim në mendjet tona.

*U qasa çap pas çapi fare lehtë
Ngadalë e mata udhën ca nga ca
Yjet mbi Krye flakëruan hatâ
Nën këmbë kisha Detin vetë
S'dija se ç'ndillte tjetri hap
Mos vallë i fundmi asisoj -
Cakun e preka prapëseprap
Disa e quajnë "Përvojë"*

Të ecurit e burrave është e ndryshme nga e grave, me përjashtim të rastit kur janë në kuadrate të disiplinuar marshimi, pasi ne të gjithë përpiqemi të ecim ndryshe nga të tjerët. Dickinson-i, mjeshtrja e Sublimes në zgrip, zor se mund të kuptohet nëse nuk ndiejmë shqisën e ironisë së saj. Ajo ecën përgjatë të vetmes udhë të mundshme, "çap pas çapi" por çapitja e saj e dalëngadaltë pranëvitet në mënyrë ironike me një titullizëm ku ajo ndien "Yjet mbi Krye," ndërkohë që ka detin nën këmbë. Duke mos e ditur nëse hapi tjetër i saj do të jetë "i fundmi asisoj" kjo i jep asaj atë mbërritje në atë cak të mbramë që ajo nuk do t'i vër emër, porse vetëm thotë që "disa" e quajnë Përvojë.

Ajo e kishte lexuar esenë e Emersonit "Përvoja", një punë e shkëlqyer në gjurmët e esesë



"Mbi përvojën" shkruar prej mjeshtrit të saj Montaigne, dhe ironia e saj është një përgjigje e përkorë ndaj fjalëve hyrëse të Emersonit "Ku ta gjejmë vetveten? Një përgjigje kundrejt një numri pyetjesh që nuk njohin cak, sepse besohet se ato nuk ekzistojnë." Caku për Dickinson-in është të mosditurit nëse tjetri hap është i fundmi asisoj. "Nëse ndokush prej nesh do ta dinte se si do ta kishim të shkuarën dhe cili është fati ynë i ardhshëm, atëherë kjo do të ishte kulmi i dijes!" Rugëtimi i mëpasshëm i Emersonit ndryshon nga ritmi i shtruar i Dickinsonit, sikurse e thotë ajo, "çap pas çapi". "Gjithçka rrjedh dhe shndrit," në mbretërinë e përvojës së Emersonit, dhe ironia e tij gjëniale është krejt ndryshe nga ironia e saj e nëndheshme. E megjithatë, asnjëri sosh nuk është ideolog dhe të dy mbijetojnë në kohë saje fuqisë që mbartin ironinë e tyre të kundërta.

Në fund të shtegut të ironisë së humbur është caku i mbramë, përtej të cilit vlera e letërsisë do të jetë e paripërtëritshme. Ironia është thjesht një metaforë, dhe rrallë ndodh që ironia e një epoke letrare të jetë si ajo e një epoke tjetër, sidoqoftë, pa rilindjen e kuptimit të ironisë humbet shumë më shumë se ajo që ne e quajmë shkrim letrar. Tomas Mani, ndër më ironikët e shkrimtarëve të këtij shekulli, duket se është bërë fir tashmë. Botohen biografi të reja të tij, dhe shkrimet për to mbështeten pothuajse gjithmonë vetëm në homoseksualitetin e tij, a thua se kësaj do mbahet gjallë interesi ynë si lexues për to, vetëm nëse vërtetohet se ishte homoseksual, dhe kjo t'i sigurojë një vend në bibliotekat tona. Nuk ndodh ndryshe as kur bëhet fjalë për Shekspirin, më së shumti përmendet biseksualiteti i tij i dallueshëm, dhe kësaj huqet e puritanëve të kohës sonë nuk kanë të sosur. Ironinë shekspiriane, sikurse dihet, jamë më të shumëkuptimshmet dhe dialektiket në tërë letërsinë perëndimore, dhe prapëseprap

ato nuk ndërmjetësojnë gjithmonë pasionet e personazheve të tij për ne, kaq e gjerë dhe e fuqishme është furtuna e tyre emocionale. Kjo është arsyeja pse Shakespeare e tejkalon epokën tonë, edhe pse ironinë e tij shpërfillen për t'u marrë me vogëlsira.

Nga ana tjetër, në çdo emocion që ngjall Tomas Mani, rrëfimor apo dramatik, ai ndërmjetësohet prej një estetike të ironisë; dhe ajo nuk mund t'u mësohet si e tillë e shembulluar tek librat Vdekje në Venecia ose Pështjellim dhe pikëllim i kahershëm pasi për shumë prej studentëve, qoftë edhe për më të talentuarit, është pothuajse e pamundur. Kur autorët rrënohen prej historisë, ne me të drejtë i shohim veprat e tyre si trakte periudhash historike, por kur ato nuk mbijetojnë për shkak të idelogjisë historike që i përshkon, mendoj se kemi të bëjmë me një dukuri tjetër.

Ironia kërkon një vëmendje të caktuar, sikurse aftësinë për të ngjallur ide kundërthënëse, edhe kur ato ndeshen me njëra-tjetrën. Po ti heqim ironinë leximit, i kemi hequr të befasishmen, gjithë të papriturën që na grish. Rrokni çfarëdo lloj libri që t'u zërë dora, një nga ata me vlera që gjykojnë e peshohen, dhe keni për të parë se ka shumë gjasa që ironia do të jetë ajo që i jep vlerë e peshë, paçka se shumë prej mësuesve tuaj nuk e dinë se çfarë është ajo se ku duhet kërkuar ajo. Ironia ta qëron mendjen prej klisheve ideologjike dhe të ndih të bësh dritë si qiriri i studuesit.

Tani po kaptoj të shtatëdhjetat, dhe në këtë moshë njeriu nuk para ka qejf të lexojë letërsi të dobët sikurse të shohë ditë të zeza, përderisa ditët i kemi të numëruara. Nuk e di nëse vdekjen ia kemi borxh Zotit a natyrës, por natyra do të bëjë të vetën, dhe ne pa më të voglin dyshim mediokritetit nuk i kemi kurrfarë borxhi, pavarësisht se çfarë turme nënkupton apo përfaqëson ai. Ngase lexuesi im ideal, për një gjysmë shekullia, ka qenë Dr. Samuel Johnson-i, po sjell fragmentin tim të parapëlqyer shkëputur nga parathënia e tij për

Shakespeare-in:

Kjo pra është fuqia e Shakespeare-it, drama e tij është pasqyrë e jetës; kushdo që kuturis në mbretërinë e imagjinatës për të rendur pas shajnive që të tjerë shkrimtarë para tij krijuan, mund të gjej tek ai ilačin shërues për dallitë e tij delirante ngase lexon aty ndenjat njerëzore në gjuhë njerëzore, prej skenash me anë të cilave një eremit mund të shkoqisë punët e botës dhe një pendestar shtigjet e pasioneve të saj."

Që të lexosh ndenjat njerëzore në gjuhën me të cilën shprehen, duhet të dish të kuptosh gjuhën njerëzore, në plotninë e saj. Kështu ti i tejkalon ideologjitë, pavarësisht nga bindjet vetjake që mund të kesh, dhe Shakespeare shfaqet para teje, sipas aftësisë që zotëron për ta zbuluar atë. Kjo do të thotë se Shakespeare të lexon më katërcipërisht se sa mund ta lexosh ti atë, edhe kur ta kesh qëruar mendjen nga klishetë. Asnjë shkrimtar para tij apo prej Shakespeare-it e më pas ka arritur të zotëroj si ai aftësinë e krijimit të thellësisë dhe larmisë së dritëhijeve të personazheve, pikëvështrime që tejkalojnë çdo lloj kontekstualizmi që u paracaktotet dramave. Johnson-i, duke e pikasur fort mirë këtë, na nxit ta lexojmë Shakespear-in që të na çlirojë nga "dalldisjet delirante." Lejomëni ta shtjelloj më tej këshillën e Johnson-it i cili na nxit gjithashtu që të pranojmë djajtë që dëbon leximi i thellë i Shekspirin. Njëri sosh është Vdekja e Autorit; një tjetër është pohimi që vetvetja është trillim; dhe tjetri në radhë është ai sipas të cilit personazhet letrarë e dramatikë janë thjesht shenja të shumta të lëna në letër. Djalli i katërt dhe më i kobshmi është mendimi se gjuha është ajo që përcakton mendimin tonë.


Sërish, dashuria ime për Johnson-

in, dhe për leximin, më shtyn të shmang polemikat, e në vend të tyre të lartësoj shumë prej lexuesve vetmitarë që takoj vazhdimisht, qoftë në auditore apo në letrat që më dërgojnë. Ne lexojmë Shekspirin, Danten, Chaucer-in, Servantesin, Dikensin, Prustin, dhe të gjithë të ngjashmit e tyre sepse ata i zgjerojnë përmasat e kuptimit të jetës. Praktikisht, ata përbëjnë Bekim, në kuptimin e vet më hyjnor me "më shumë jetë në një kohë që s'ka kufij." Ne lexojmë pafundësisht për shumë arsye, disa prej tyre të ditura: ngase s'mund ti njohim plotësisht njerëzit, t'i njohim aq sa të mos ketë më nevojë: ngase kemi nevojë të njohim më mirë veten; ngase kemi nevojë për dijen jo vetëm në lidhje me veten dhe të tjerët, por edhe se si janë punët e kësaj bote.

Prapëseprapë, motivi më i fuqishëm dhe themelor për një lexim të thellë të veprave tradicionale klasike jo pak të nëpërkëmbura, është gjurmimi i ëndjes së mundimshme. Afërmendsh që nuk jam nxitës i leximeve erotike, por ëndja e mundimshme mua më duket përkufizimi më i mirë i Madhështores në letërsi, edhe pse kjo ëndje e epërme mbetet kërkimi i pareshtur i lexuesit. Eziston pra, Madhështimi i lexuesit, dhe duket të jetë i vetmi tejkallim i kufijve normal të ekzistencës që mund të arrijmë ndonjëherë, me përjashtim të rastit më skajshëm që ne e quajmë "të rënit në dashuri." Ju bëj thirrje të lexoni çka i përshatet shpirtit tuaj, çka i jep peshë mendimit dhe gjykimin. Lexoni thellësisht, jo për të besuar, as për të pranuar, as për të kundërshtuar, porse për të mësuar të njësoheni me atë natyrë si e juaja që edhe shkruan edhe lexon.

/exlibris/

Përktheu: Granit Zela



E jashtëzakonshme

Vajza me flokët më të gjatë në botë

Një 17-vjeçare indiane ka arritur ta ruajë kurorën e saj si adoleshentja me flokët më të gjatë në botë për më shumë se një dekadë pasi vendosi të mos priste më flokët sepse pati një përvojë të keqe në parukeri. Nilanshi Patel, nga qyteti i vogël i Modasa në shtetin Gujharat, mbetet e para në botë sipas librit të rekordeve Guinness. Vajza ka treguar se flokët më të shumti i mban të lidhur gërshet, por ndonjëherë preferon t'i kapë lart,



duke shpjeguar se problemet më të mëdha i has kur shkon për të notuar.

FOTO E DITES



Në fotografi shihen helikopterët që transportonin presidentin e ShBA-së, Donald Trump, mbi Alpet Zvicerane gjatë rrugëtimit të tij në Forumin Ekonomik Botëror në Davos, Zvicër. /AFP/

E rrallë

Kompania japoneze fillon fluturimet e para testuese të veturës më të vogël fluturuese

Kompania japoneze "SkyDrive Inc" ka filluar testimet e para të prototipit të veturës fluturuese që pilotohet nga njeriu. Kjo kompani shpreson se do të mund ta bëjë



demonstrimin publik të veturës gjatë kësaj vere. Fluturimet e fundit testuese janë kryer brenda një objekti që kompania e përdor për hulumtime në Nagoya.

BARSOLETA E DITËS



Shkon biondina te mjeku. I kishte të dy veshët e skuqur.
 - Doktor, e kam djegur veshin - ankohet biondina.
 - Si ndodhi!? - pyet i habitur mjeku.
 - Isha duke hekurosur kur telefonoi i dashuri im dhe, në vend të telefonit, e vendosa hekurin e skuqur në vesh!
 - fillon të sqarojë biondina.
 - Po veshin tjetër si e dogjët? - sërish pyet i habitur mjeku.
 - Po telefonoi sërish ai drej... - vazhdon të ankohet biondina.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Në ora 18:00 Spies in Disguise 3D

I Animuar/Aksion/Aventurë; 1 orë 42 min

Rolet: Will Smith, Tom Holland, Ben Mendelsohn, Karen Gillan, Rashida Jones, DJ Khaled, Masi Oka

Regjia: Troy Quane, Nick Bruno




Në ora 18:00 Jumanji; The Next Level 3D

Aksion/Aventurë/Komedi; 2 orë 03 min

Rolet: Dwayne Johnson, Jack Black, Kevin Hart, Karen Gillan, Nick Jonas, Awkwafina, Ser'Darius Blain, Madison Iseman, Morgan Turner, Alex Wolff, Danny Glover, Danny DeVito, etj.

Regjia: Jake Kasdan



Çdo natë në ora 20:00 STAR WARS; THE RISE OF SKYWALKER 3D

Aksion/Aventurë/Fantazi; 2 orë 21 min

Rolet: Daisy Ridley, Adam Driver, Mark Hamill, John Boyega, Oscar Isaac, etj

Regjia: J.J. Abrams



Çdo natë në ora 22:30 THE GRUDGE

Horror/Mister; 1 orë 34 min

Rolet: Sarah Michelle Gellar, Jason Behr, Kadee Strickland, Clea Duvall and Bill Pullman


Regjia: Takashi Shimizu



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, [fb: Kino ABC](https://www.facebook.com/kinoabc).

| | | | | | |
|---|--|---|---|--|--|
| <p>DASHI Me Diellin dhe Hënën përpikuni të keni një humor pozitiv për t'i zgjidhur konfliktet e vjetra, pa krijuar të reja.</p> | <p>DEMI Të favorizuar nga Hëna do të keni mundësi të angazhoheni në projektet që keni dashur prej shumë kohësh.</p> | <p>BINJAKËT Çfarëdo që të keni në mendje, meditoni çdo zgjedhje, çdo vendim, veçanërisht nëse ka para, biznes, investime në fjalë.</p> | <p>GAFORRJA Mundohuni të mos veproni impulsivisht: kjo ditë e shënuar nga faza e Hënës së plotë në shenjën tuaj, kërkon vëmendje, durim dhe reflektim!</p> | <p>LUANI Gaboheni nëse mendoni se partneri është drejtpërdrejt përgjegjës për gjendjen tuaj të keqe. Do të vuani nga dhimbja e kokës e shkaktuar nga migrena.</p> | <p>VRIGJËRESHA Fryma konstruktive dhe miratimi i njerëzve me ndikim ju japin besim dhe optimizëm përsëri!</p> |
| <p>PESHORJA Qëndrueshmëria nuk është pika juaj e fortë, por është e tepërt të presësh që të tjerët të përshtaten me ndryshimet e humorit tënd!</p> | <p>AKREPI Një konfrontim me miqtë ndryshon perspektivën e vlerave tuaja. Do të jeni më pak ambiciozë në karrierën tuaj dhe do t'i jepni më shumë hapësirë dialogut e bashkëpunimit.</p> | <p>SHIGJETARI Tani për tani do ta keni shumë të lehtë t'i afroheni dikujt që e pëlqeni dhe keni ndjenja.</p> | <p>BRICJAPI Ditë mjaft e zënë. Mosmarrëveshjet me njerëzit e afërt do të zgjidhen dhe do të jenë në favorin tuaj.</p> | <p>UJORI Nëse flisni për dashuri, një jetë plot aventura është e këndshme, por të kesh një person të cilit i beson është gjë tjetër.</p> | <p>PESHQIT Dita është fantastike nga shumë këndvështrime, një ilaç për humorin, veçanërisht nëse planifikoni takime prestigjioze, private ose profesionale.</p> |

Përfundimisht ndahen Wendy Williams dhe Kevin Hunter



Moderatorja e njohur Wendy Williams dhe Kevin Hunter janë ndarë zyrtarisht. Ish-çifti shtëpinë e përbashkët në New Jersey do ta shesin dhe shumën e fituar do ta ndajnë sipas rregullave ligjore. Mediat e huaja shkruajnë se të gjitha procedurat


ligjore të divorcit kanë përfunduar. Williamsi do ta mbajë shtëpinë në Florida dhe se Hunter do ta mbajë një shtëpi tjetër të tyre në New Jersey. Wendy Williams dhe Kevin Hunter ishin të martuar 20 vjet më parë dhe kanë një fëmijë së bashku, djalin 19-vjeçar Kevin Jr.

DiCaprio dhe De Niro do të luajnë bashkë në filmin e ri të Scorseses



Dy aktorët e famshëm, Leonardo DiCaprio dhe Robert De Niro, do të jenë pjesë e filmit të ri të Martin Scorseses. Dyshja kanë luajtur bashkë në filmin e vitit 1993, "This Boy's Life", ndërsa filmi i ardhshëm ku do t'i shohim bashkë do të titullohet "Killers of the Flower Moon".

"Kam mësuar shumë nga të dy (De Niro dhe Scorseses). Jam i lumtur që mund t'i quaj bashkëpunëtorët e mi... është nder i veçantë që pas rreth 30 vjetësh do ta kem mundësinë të luajë krahas Bobit (De Niro) në dramën e ardhshme të Martin Scorseses, 'Killers of the Flower Moon'", ka deklaruar DiCaprio.



Bashkohen Channing Tatum dhe Jessie J


Aktori i njohur Channing Tatum dhe këngëtarja Jessie J janë bërë bashkë së bashku. Një burim i afërt me çiftin ka thënë për "People" se ata janë bërë bashkë sërish pas një muaji të ndarjes. "Ata ishin disa javë larg njëri-tjetrit, por më pas vendosën që të jenë bashkë sërish", ka thënë ky burim.

Jessie dhe Tatum për herë të parë u panë bashkë në tetor të vitit 2018 dhe u ndan nga njëri-tjetri tek pas një viti në dhjetor të vitit 2019. Burimi në fjalë pas ndarjes së çiftit kishte theksuar se "ata nuk kishin vend për dramë. Ata vendosën t'i ndajnë rrugët e njëri-tjetrit dhe mbetën shokë të mirë".

Zbulohet shkaku i vdekjes së reperit 21-vjeçar

Reperi amerikan Juice Wrld u nda nga jeta rreth një muaj më parë në moshën 21-vjeçare. Vdekja e tij u raportua si fillim nga mediat, por më pas u konfirmua edhe nga autoritetet mjekësore. Si

fillim u mendua se shkak i vdekjes u bë mbidoza, ndërsa tani ka dalë rezultati final i autopsisë. Mediat e huaja shkruajnë se Juice kishte konsumuar një sasi të madhe lëndësh narkotike dhe kjo i shkaktoi sulm në zemër.



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT
PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE

"BUJQËSIA"

TEL: 045/82 82 82

Bruqi: Flamurtari do të mbetet në Superligë

Futbollisti Agron Bruqi është shumë optimist se skuadra e Flamurtarit do ta sigurojë mbijetesën në IPKO Superligën e Kosovës në futboll. "Personalisht kam besim të madh në ekipin që e kemi dhe do të arrijmë të mbesim në Superligë, ani pse nuk do të jetë aspak lehtë. Konkurrent kryesor drejt realizimit të këtij synimi i kemi Trepçën '89 dhe Drenicën, por nëse të gjithë angazhohemi njëqind për qind, atëherë Flamurtari do të bëjë garë në elitë edhe në sezonin 2020/2021", ka thënë Bruqi

**EPOKA E RE****Veton ZYMBERI**

PRISHTINË, 23 JANAR - Skuadra e Flamurtarit pati një sezon mesatar në vjeshtë, pasi përfundoi në pozitën e nëntë me 19 pikë. Mesfushori dhe një nga lojtarët më të dalluar në këtë klub, Agron Bruqi, ka thënë të enjten për "Epokën e re" se rezultatet e skuadrës nga kryeqyteti i Kosovës kanë mundur të jenë shumë më të mira. "Rezultatet nuk kanë qenë aq pozitive, pasi me pak fat në disa ndeshje kemi mundur të dalim shumë më mirë dhe tash t'i kishim të paktën edhe katër pikë të tjera. Megjithatë, na mbetet shumë punë për sezonin pranveror", ka

thënë Bruqi, i cili më pas është shprehur i kënaqur me fazën përgatitore të skuadrës së Flamurtarit, derisa ka zbuluar se ky klub do të udhëtojë në fund të muajit në Turqi për t'i mbushur "bateritë" për pranverë. "Po stërvitemi nga dy herë në ditë dhe deri tash përgatitjet janë duke shkuar sipas planit të shtabit teknik, kurse fazën e dytë do ta vazhdojmë në Turqi dhe atje do të zhvillojmë edhe disa ndeshje miqësore për të qenë maksimalisht të përgatitur për pranverë", ka shtuar ai.

Flamurtari edhe në këtë edicion synim e ka mbijetesën në IPKO Superligë, kurse është katër pikë larg nga pozita e tetë që e siguron

mbijetesën. Mesfushori nga Deçani ka thënë se kuqezinjtë kanë ekip të mirë dhe me një angazhim maksimal nga të gjithë në klub, mbijetesë do të jetë e sigurt. "Personalisht kam besim të madh në ekipin që e kemi dhe do të arrijmë të mbesim në Superligë, ani pse nuk do të jetë aspak lehtë. Konkurrent kryesor drejt realizimit të këtij synimi i kemi Trepçën '89 dhe Drenicën, por nëse të gjithë angazhohemi njëqind për qind, atëherë Flamurtari do të bëjë garë në elitë edhe në sezonin 2020/2021", ka thënë Bruqi. Flamurtari në shtatëmbëdhjetë ndeshjet e zhvilluara në sezonin vjeshtor ka regjistruar pesë fitore, katër barazime dhe tetë humbje.

SHKURT

Tottenhami bën ofertë për Muriqin

Trajneri Jose Mourinho e ka pranuar publikisht se Tottenham Hotspur po vuan mungesën e një sulmuesi, i cili do të ishte zëvendësim për Harry Kanen. Ndërsa gazeta turke "Aksam" shkruan se "Spurs" është gati të ofrojë 20 milionë paunda për sulmuesin e Kosovës, Vedat Muriqi. Shtatlati ka shkëlqyer në këtë edicion me fanellën e Fenerbahçes dhe kjo ka bërë që shumë klube të shfaqin interesim për shërbimet e tij.

Drita huazon Rexhepin te Vitia

Portieri Leutrim Rexhepi karrierën do ta vazhdojë në skuadrën e Ligës së Parë, Vitia. Ai është huazuar nga skuadra e Dritës për gjashtë muajt e ardhshëm. "Gardiani ynë Leutrim Rexhepi është larguar në formë huazimi te skuadra e Ligës së Parë, KF Vitia, për gjashtë muajt e ardhshëm. Leo vitin e kaluar kishte pësuar një lëndim dhe iu nënshtrua një operacioni, i cili e mbajti jashtë fushës për tetë muaj. Pas riaftësimi të plotë, Leo ka filluar nga dita e parë fazën përgatitore me ekipin tonë dhe do të jetë i gatshëm që ta ndihmojë ekipin nga Vitia në synimet e saj për këtë stinor", thuhet në njoftimin e Dritës.

Lladrovci largohet nga Drenica

Futbollisti Drilon Lladrovci nëpërmjet një postimi në "Facebook" ka bërë me dije se nuk do të jetë më pjesë e skuadrës së Drenicës nga Skenderaj. "Shfrytëzoj rastin t'ju informoj se kam shkëputur kontratën me Klubin 'KF Drenica' me marrëveshje të dyanshme. Klubit, stafit dhe bashkëlojtarëve ju uroj fat dhe suksese në të ardhmen si dhe i falënderoj për kohën që kemi kaluar së bashku. Nga ky moment jam lojtar i lirë dhe i hapur për oferta", ka thënë Lladrovci, i cili në të kaluarën ka qenë pjesë e Feronikelit dhe Flamurtarit.

Roshi nuk e zbulon skuadrën e re

Menaxheri i Odise Roshit, Adrian Aliaj, u shpreh pak ditë më parë se një ofertë nga La Liga ka mbërritur për sulmuesin e Shqipërisë. Ditët e ardhshme do të jenë vendimtare për të përcaktuar karrierën e këtij futbollisti, që me një transferim të tillë do të arrinte kulmin. I pyetur nga gazetarët shqiptarë për këtë çështje, Odise Roshit "i qesh buza" kur flitet për elitën e kampionatit spanjoll, por dëshiron të pritë deri në zyrtarizim, duke mos e besuar as vetë një arritje të tillë. "Është kënaqësi shumë e madhe, La Liga është një nga kampionatet më të forta. Është kënaqësi vërtet për mua, por për momentin jam te ekipi im. Kur të jetë zyrtarë, atëherë po. Unë personalisht kam shumë dëshirë që të kapim Botërorin, shpresoj që të futemi aty", ka thënë Roshi.

Nora fiton medaljen e bronzë

PRISHTINË, 23 JANAR - Nora Gjakova e ka nisur vitin 2020 me medaljen e bronzë, të fituar sot në Grand Prixin e xhudos, që po mbahet në Tel Aviv të Izraelit. Kampionia e Evropës 2018 dhe nënkampione e 2019-tës fitoi të bronzën në kate-

gorinë -57 kilogramë, përmes repesazhit. Ajo mposhti në luftën për të bronzën portugezen, Telma Monteiro. Në luftën e parë mposhti Leung të Kinës, pastaj Kionkinan e Ruisë, për t'u ndalur në çerekfinale nga Receveaux e

Francës, ndërsa në luftën e parë në repesazh, mposhti Larisa-Alexandra Florian të Azerbajxhanit. Krahas medaljes së artë, Nora fitoi edhe 700 pikë Olimpikë në rrugën drejt normës Olimpikë Tokio 2020.



Nadali dhe Halepi bëjnë ligjin në Australian Open

MELBOURNE, 23 JANAR - Dita e katërt e grand slamit të Australian Openit në tenis është mbyllur me fitoret e Rafael Nadalit dhe Simona Halepit. Spanjoli, numri një në botë për meshkuj, fitoi 3-0 (6-3, 7-6, 6-1)

ndaj Federico Delbonis. Ndashje me rivalitet vetëm në setin e dytë, pasi në pjesën tjetër loja u komandua nga Nadali, që avancoi në raundin e tretë. Një biletë për në raundin e tretë siguruan edhe

zvicserani Stanislav Wawrinka (3-2 ndaj Andreas Seppi) dhe australiani Nick Kyrgios (3-1 ndaj Gilles Simon). Te femrat ish-numri 1 në botë, tenistja rumune Simona Halep, arriti fitore 2-0 (6-2, 6-4) ndaj Harriet

Dart. Ndashje e dominuar dhe fituar me lehtësi nga Halepi, që avancoi më tej. Në raundin e tretë janë kualifikuar edhe italiania Camila Giorgi, holandezja Kiki Bertens si dhe Anett Kontaveit e Estonisë.



Rashica: Kualifikimi në Evropian do të ishte arritja më e madhe për Kosovën

BREMEN, 23 JANAR - Ylli i Përfaqësues së Kosovës, Milot Rashica, për momentin është i fokusuar tek ekipi i tij, Werder Bremen, me të cilin po bën paraqitje mbresëlënëse. Por, në mendjen e tij nuk ka se si të mos jetë edhe Përfaqësuesja e Kosovës. Pas dy muajsh "dardanët" i pret një ndeshje jetike me Maqedoninë e Veriut, në gjysmëfinale të "play-off"-it të Ligës së Kombeve. Përmes ndeshjes që do të luhet në Shkup, Kosova mund ta kërkojë kualifikimin në "Euro 2020" në finalen eventuale ndaj Gjeorgjisë ose Bjellorusisë. Dhe, vushtrriasi shpreh optimist se lojtarët e drejtuar nga Bernard Challandesi do të kalojnë mirë në muajin mars. "Për ne, kualifikimi në Evropian do të ishte gjitha dhe e arritura më e madhe e të gjitha kohëve", ka thënë Rashica për faqen zyrtare të Werder Bremenit.

23-vjeçari e ka kujtuar edhe ndeshjen e parë zyrtare të Kosovës ndaj Finlandës, në kualifikimet e Botërorit 2018, vetëm pak muaj pas pranimit të Federatës së Futbollit të



Kosovës në UEFA e FIFA. Atë takim ai e konsideron si të paharrueshëm dhe vërtet historik. Rashica, po ashtu, iu ka treguar gjermanëve se kudo që shkon, ekipi kombëtar i Kosovës i ka prapa tifozët, por edhe mbarë popullin kosovar. "Kudo që shkojmë, të gjithë na vijnë pas. Njerëzit mbesin në rrugë pasi stadiumet janë shumë të vogla për ne. Një stadium më i madh do të ndërtohet, sepse kapaciteti i stadiumit

aktual nuk e përballon kërkesën e lartë të tifozëve. Është një çmenduri", ka përfunduar Rashica. Kosova e bëri një kampanjë të shkëlqyeshme në kualifikimet e Euro 2020, por përfundoi në pozitën e tretë në Grupin A, prapa Anglisë e Republikës Çeke, që ishte e pamjaftueshme për t'u kualifikuar direkt. Tash Rashica me shokë do të mundohen ta shfrytëzojnë Planin B për ta prekur ëndrrën evropiane.

Lakersat dhe Houstoni u rikthen fitoreve

Nju Jork, 23 janar - Lakersat rikthehen te fitorja, pasi e mposhtën me rezultat 100-92 New Yorkin jashtë fushës, ndeshje e vendosur në pjesën e dytë në favor të ekipit kalifornian. Dyshja Davis - James realizoi 49 pikë së bashku, duke qenë vendimtare në këtë sukses. Humbet skuadra tjetër e Los Anxhelosit, ajo e Clippersit, që është mposhtur me rezultat 102-95 nga Atlanta, duke lëshuar edhe vendin e dytë në Perëndim. Edhe pse Clippersat dominuan në ndeshje



(Harrelli 30 pikë), duke u shkëputur deri në 21 pikë, nuk arritën të fitojnë. Për Atlantan u dallua Collins, autor i 33 pikëve dhe 16 reboundeve. Pas katër humbesh rikthehet te fitorja skuadra e Houstonit, që mundi me rezultat 121-105 Denverin, një përballje mes dy ekipesh pretendente në Perëndim. Skuadra teksane dominoi gjatë gjithë kohës në ndeshje dhe e meritoi fitoren, ku u

dalluan Westbrook me 28 pikë e Hardeni me 27. Për Denverin shkëlqeu Jokiqi, me një "triple double" (19 pikë, 12 rebounde e 10 asistime), por që mbetën për statistikë. Fitore të lehtë arriti skuadra kampione e Torontos, që mundi 107-95 Philadelphian (VanVleet 22 pikë), ndërsa Utah Jazzi mposhti 129-96 Golden Staten (Mitchell 23 pikë).

SHKURT

Unitedi planifikon rikthimin e Tevezit

Sulmuesi Carlos Tevez kishte paralajmëruar ditë më parë se do të pensionohet në Boca Juniors, por sot mediat në ishull raportojnë se argentinasi mund të rikthehet sërish në skuadrën e Manchester Unitedit. Sulmuesi ka qenë pjesë edhe e West Hamit dhe Manchester Cityt, kurse për Unitedin luajti në periudhën 2007-2009. Tevezi shihet si zëvendësues për Marcus Rashford, i cili ka pësuar një lëndim dhe do të mungojë për një kohë të gjatë.

Mourinho: Kemi mungesë të sulmuesve

Tottenham Hotspur arriti të rikthehet te fitoret në ndeshjen ndaj Norwichit (2-1). Pavarësisht kësaj trajneri, Jose Mourinho e shqetëson faktin që skuadra ende nuk e ka gjetur zëvendësuesin e të lënduarit Harry Kane. "Jemi në një situatë kur duhet të mendoj. Unë shikoj në bankinë dhe nuk kemi lojtarë sulmues", ka thënë Mourinho. "Kur Chelsea dëshiron të fitojë, e futë në lojë Michy Batshuayi. Kur Manchester City dëshiron ta zëvendësojë Gabriel Jesus, e futë në lojë Sergio Agüero", ka shtuar Mourinho.

Lampardi: Më ka pëlqyer gjithmonë Cavani

Chelsea ka bërë një ofertë zyrtare në adresë të PSG-së për Edison Cavanin. 33-vjeçari nuk po gjen më hapësira në ekip pasi duket se treshja Neymar - Icardi - Mbappe është e pazëvendësueshme. Nga ana tjetër, sulmuesi kryesor i Chelseas, Tammy Abraham, pësoi një dëmtim në barazimin 2-2 në derbin e Londrës përballë Arsenalit. "Më ka pëlqyer gjithmonë mentaliteti dhe qëndrimet e tij", ka thënë Frank Lampard. Mediat angleze shkruajnë se nëse Chelsea do ta huazojë Cavanin duhet të derdhë në arkat e parisienëve 12.6 milionë paund.

Otamendi drejt rikthimit te Valencia

Nicolas Otamendi në vitin 2015 për 44.5 milionë euro u transferuara nga Valencia në Manchester City. Mbrojtësi argentinasi mund të rikthehet sërish në "Mestalla", pasi klubi spanjoll po synon të rikthejë gjatë verës. Hapësirat jo të shumta në këtë sezon nga trajneri Pep Guardiola mund të ndikojnë që Otamendi të rikthehet në La Liga.

Moses prezantohet tek Interi

Interi ka prezantuar përforcimin e ri për këtë afat. Ai është sulmuesi anësor i Chelseas, Victor Moses. Ky i fundit është lojtar i preferuar i Antonio Contes, pasi edhe në kohën kur Conte e drejtonte klubin anglez kishin arritur ta fitonin së bashku titullin në Premierë Ligë. Nigeriani Moses është i huazuar me mundësi blerje në fund të sezonit. "Transferim i kompletuar. Victor Moses është kaltër e zi", ka shkruar faqja zyrtare e Interit.

Bayerni do t'i largojë pesë yje

Bayern Munchen është i detyruar ta ndjekë vendin e parë në Bundesliga, pasi aktualisht kjo skuadër është e dyta në renditje dhe është katër pikë larg Leipzigit kryesues. Një rezultat që nuk kënaq drejtuesit, të cilët duket se janë gati të bëjnë një revolucion të vërtetë në verë. Sipas "Bild"-it, pesë yje mund të largohen nga Bayerni në muajt e ardhshëm: Thiago, Thomas Muller, Manuel Neuer, Javi Martinez dhe Jerome Boateng. Lojtarë që pritet të zëvendësohen nga një merkato e rëndësishme, për të cilën janë bërë gati të investohen 110 milionë euro.

NBA

| | |
|---------------------------|---------|
| Detroit - Sacramento | 127-106 |
| Orlando - Oklahoma | 114-120 |
| Toronto - Philadelphia | 107-95 |
| Atlanta - Clippers | 102-95 |
| Boston - Memphis | 119-95 |
| Miami - Washington | 134-129 |
| New York - Lakers | 92-100 |
| Chicago - Minnesota | 117-100 |
| Houston - Denver | 121-105 |
| Phoenix - Indiana | 87-112 |
| New Orleans - San Antonio | 117-121 |
| Golden State - Utah Jazz | 96-129 |



KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE
REGIONAL WASTE COMPANY
REGIONALNA KOMPANIJA ZA UKLANJANJA OTPADA

Tel. +381(0)390/321 588
+381(0)390/324 034
www.cabrati.com
e-mail. info@cabrati.com
Gjakovë - Gjakovë

K.R.M. "ÇABRATI"

Në bazë të nenit 21 të Ligjit numër 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike (i publikuar në Gazetën Zyrtare me datë 15.06.2008), i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin numër 04/L-111 (i publikuar në Gazetën Zyrtare me datë 30.05.2012), nenit 21 paragrafi 21.3.6 të Statutit të KRM "Çabrati" Sh.A., Bordi i Drejtorëve në takimin e mbajtur me datë 23.01.2020, vendosi që me datë 24.01.2020 të shpall ketë:

KONKURS

Pozita: Kryeshef Ekzekutiv
I përgjegjjet: Bordit të Drejtorëve
Vendi: Gjakovë

Kushtet dhe kualifikimet e kërkuara:

Bordi i Drejtorëve dëshiron të sigurohet që të gjithë kandidatët potencial të jenë persona me integritet të njohur të cilët i plotësojnë kushtet e kualifikimit sipas nenit 17.1, si dhe plotësojnë kriteret e pavarësisë sipas nenit 17.2 pikat (d), (f), (j), (k) dhe (l), nenit 17.3 pika (a), dhe (b), detyrimit të dhënies së deklaratës nën betim sipas nenit 17.5 të Ligjit për Ndërmarrje Publike dhe se kanë përvojën e nevojshme profesionale dhe shkollimin e kërkuar për pozitën në fjalë. Përveç këtyre kushteve të përgjithshme kandidatët duhet të plotësojnë edhe këto kushte të veçanta:

- Të ketë së paku 5 vite përvojë në nivel të lartë të menaxhmentit në fushën e administrimit të biznesit, financave korporative, financa, menaxhim i thesarit, banka, konsulencë në biznes, industri ose nga një fushë tjetër e shkencës e cila ka të bëjë me veprimtarinë afariste të NP-së për së paku 5 vite, të ketë qenë kontabilist publik, jurist i kualifikuar, ose anëtarë i kualifikuar i një profesioni tjetër i cili ndërlihdhet ngushte me veprimtarinë afariste të NP-së;
- të ketë integritet të lartë moral e profesional;
- të ketë aftësi të dëshmuara në menaxhim;
- njohja e gjuhëve të huaja është përparësi;
- të mos jetë i dënuar ose nën hetim;
- një program zhvillimor për kompaninë.

Detyrat dhe përgjegjësit kryesore:

- Ne pajtim me Ligjin, Kodin e Etikës, Qeverisjen Korporative për Ndërmarrjet Publike dhe Statutin, duke iu nënshtruar vetëm përkufizimeve të BD ka autoritetin të lidhë kontrata për Kompaninë;
- Të gjitha çështjet në lidhje me biznesin e Kompanisë të cilat nuk janë në përgjegjësi të Mbledhjes së Përgjithshme të Aksionarëve, Bordit të Drejtorëve, Komisionit të Auditimit apo Zyrtarit të Auditimit të Brendshëm do të vendosen sipas direktivave dhe përgjegjësisë së Kryeshefit Ekzekutiv;
- Këshillon dhe asiston Bordin e Drejtorëve në përcaktimin e strategjisë së kompanisë si dhe planet e saja strategjike afatgjate;
- I ofron Bordit të Drejtorëve kurdo që është e nevojshme dhe së paku një herë në tre muaj raporte për transaksionet kryesore të ndërmarrja nga kompania dhe për vendimet kryesore të ndërmarrja nga menaxhmenti në lidhje me udhëheqjen e biznesit dhe të punëve të kompanisë;
- Ofron Bordit të Drejtorëve rregullisht së paku çdo tre muaj raportet e matjes së performancës së kompanisë;
- Themelon dhe rishikon strukturën organizative të kompanisë, si dhe të fuqisë së ndërlidhjes në mes të udhëheqësve dhe të punësuarve në kompani;
- I ofron Komisionit të Auditimit të gjitha informatat dhe asistencën që mund të kërkohet;
- Merr pjesë në të gjitha mbledhjet e përgjithshme.

Paga: Në pajtim me politikën e kompensimit të aprovuar nga Bordi i Drejtorëve.

Procedura e aplikimit:

Aplikacionit duhet bashkangjitur edhe këto dokumente:

- CV-ja (Biografia);
- Letër njoftimi - kopje;
- Letër motivimi;
- Deklarata nën betim;
- Diplomën e kualifikimit (minimum universitare) - kopje;
- Dëshminë se nuk jeni nën hetim, jo më të vjetër se 3 muaj - origjinale;
- Programi zhvillimor për kompaninë.

Dorëzimi i kërkesës dhe dokumentacionit përkatës bëhet tek Sekretaria e Kompanisë në zaf të mbyllur me shënim: "Për pozitën: Kryeshef Ekzekutiv i KRM "Çabrati" Sh.A.". Afati i dorëzimit është nga data 24.01.2020 deri me datë 24.02.2020 në ora 16.00.

Kërkesat e dorëzuara pas datës së fundit dhe kërkesat e pakompletuara nuk do të pranohen nga Bordi i Drejtorëve. Vlerësimi formal dhe intervista do të bëhen pas përfundimit të afatit për aplikim, ndërsa NP mban të drejtën e formimit të listës së shkurtër me aplikant.



**MILLENNIUM
FOUNDATION
KOSOVO**

Address: str. "Migjeni" (ex-Bank of Ljubljana Building, floor IX)
Postal Code: 10000 Prishtina, Kosovo
Email: procurement@millenniumkosovo.org

PROCUREMENT NOTICE

AMENDMENT # 1

FOR THE EXTENSION OF DEADLINE FOR SUBMISSION OF PROPOSALS

TO REQUEST FOR PROPOSALS

Publication reference: PROCUREMENT OF QUALITY CONTROL SUPERVISING CONSULTANT FOR DHM IMPLEMENTATION

Reference No.: RFP / MFK /2019/ QCBS / No. 026

A specific procurement notice of above mentioned procurement activity, was published on 09 December 2019 in dgMarket, UNDB Online, local newspapers, and Millennium Foundation of Kosovo website.

In accordance with Section I, ITC Clause 9 of the Request for Proposal (RFP), and based in Consultant's requests the Millennium Foundation of Kosovo has taken a decision to extend the proposal submission date.

It is notified that the dates for receiving and opening of the proposals has been extended as follows:

Proposals must be submitted no later than 14:00 hours p.m. (Kosovo time), on 06 February 2020.

The Opening of proposals: 06 February 2020, 14:30 hours p.m. (Kosovo time).

All other terms and conditions of the RFP remain unchanged. The above amendment to the RFP constitutes an integral part of referenced RFP.

EoT

NJOFTIM

Njoftojme te gjithë kliente se Kompania " Restaurant Lumbardhi " SHPK me seli ne Prizren ka marre vendim te shuaje biznesin me numer te regjistrimit : 810519134 dhe ka caktuar likuidatorin per zhvillimin e procedures se Likuidimit . Njoftohen te gjith klientet qe kan raporte kreditore - debitore ne kete shoqeri te paraqiten ne afatin 30 ditor nga data e shpalljes ne gazet e.

OBAVESTENJE

Obavjestamo da Tvrk " Restaurant Lumnardhi 'Doo u Prizrenu doneo odluku da ugasi biznis po br . regjistra 8110519134 I ujedno imenovao Likfikatora o sprovjend-ju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obavezei potrazivanja u navedenoj firmi , da se jave u roku od 30 od dana objavljanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the Company " Restaurant Lumbardhi " LCC in Prizren has come to the decision to quit its business with registry :810519134 . The company has appointed a liquidator who is going to Oversee the liquidator process . All clients who have the mortgager - mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement publication.

Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898
Sallon Depilimi Lume's Details
lumesdetails
Mbrrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

www.facebook.com/gjeipuneshpeite

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Esat Mehmeti, shpall të pavlefshme diplomën e SHMT. "Anton Çetta" Skenderaj.

► Ferid Salihu, shpall të pavlefshme diplomën dhe dëftesat e SHMP. "Qendra e Kompetencës " Skenderaj.

► Nora Ballazhi shpalle te pavlefshme Diplomën e Fakultetit pran fakultetit te Prishtinës ,Fakulteti Filozofik - Drejtimi Shkencat Politike.

► "Mani 5" Sh.p.k shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me numër: 811280487.

► Sabrije Hasani, shpall të pavlefshme diplomën e shkollës SH.M.L "Hivzi Sylejmani" në Fushë Kosovë.

► "Lux Dentima", SH.P.K. me numër të biznesit 810190249 me adresë në Prishtinë, Rr, Elbasanit p.n i njofton të gjithë debitorët dhe kreditorë se ka marre vendim për zvogëlimin e kapitalit themelor, zvogëlimi i kapitalit themelor do të bëhet nga shuma fillestare 50000 (pesëdhjetë mijë) në 5000 Euro.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokal në qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

► Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

► Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veterikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.

► Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

► Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.

► Kërkojmë 4 bashkëbanuese, studente, banesa gjendet te Parku i qytetit, kati i I-rë, ka 3 dhoma, banjo , ballkon, çmimi për person është 50 euro plus shpenzimet . Për info: 045/699-221.

Shes truallin prej 36 arë në fshatin Besi; 150 metra nga magjistranja Prishtinë-Besianë. Trualli ka gjithë infrastrukturën e nevojshme dhe është shumë i përshtatshëm dhe për banim kolektiv. Po ashtu lëshojmë me qira vendin për restorant me një pamje atraktive dhe piktoreske me në një lartësi të madhe mbidetare.
Tel. 044-413-197.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

